

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME STEFAN SURLICIN

Beograd | Data: 19 qershor, 2017

Kohëzgjatja: 110 minuta

Të pranishëm:

Stefan Surlic (I intervistuari)
Marijana Toma (Intervistuesja)
Boris Shebez (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Marijana Toma: Mirë për fillim nëse mundeni të na prezantoheni, të na i tregoni të dhënat bazike të biografisë tuaj, ku je i lindur, emri, mbiemri dhe të fillojmë bisedën?

Stefan Surlic: Mirëdita, unë quhem Stefan Surlic, jam i lindur në Prishtinë, me 30 janar, 1989. Tani jam doktorant në Fakultetin e Shkencave Politike dhe asistent në lëndën Politikë Krahasuese.

Marijana Toma: Stefan, a mund të më tregoni diçka për fëmijërinë tuaj, lidhur me familjen tuaj, prindërit, për Prishtinën për kohën kur ti ke jetuar atje?

Stefan Surlic: Ishte atëherë një periudhë shumë interesante, të rritem përgjatë viteve të '90-ta dhe për dallim nga të gjitha ato tregime të zeza dhe të gjitha atyre që kanë ndodhur përgjatë të '90-tave, unë fëmijërinë time kryesisht e kam me kujtime të bukura dhe vet rrita ime në Prishtinë, vërtetë për mua ishte shumë specifike. Unë rrjedh nga një familje intelektuale, që do të thotë, nëna ime është juriste e diplomuar, babai im është inxhinier i makinerisë. Andaj, ai qytet, Prishtina është diçka për mu, ka përmasa të ideale për funksionimin e një familje katër anëtarëshe, unë kam motrën që është më e madhe dhe shikuar nga një aspekt nuk është një qytet i vogël për ta quajtur provincë, por prapë shikuar nga ana tjetër përfaqësonte në atë kohë një kryeqytet të Krahinës Autonome. I ka pasë disa kapacitete infrastrukturore që të mundësonin krijimin e vetëvetes dhe fëmijëve tu dhe nuk e di, bash shpesh bisedoj me prindërit e mi sikur mos të kishte qenë lufta, sikur mos të ishin ato mosmarrëveshje, a do kishim jetuar edhe më tutje në Prishtinë, dhe a do të kisha studijuar unë në Beograd apo Novi Sad si prindërit e mi apo unë do të vendosja që të qëndroj atje, por...

Ajo që ndoshta do të ishte interesante që të më dëgjoj dikush përgjatë viteve të '90-ta, kemi qenë të vetëdijshëm se diçka nuk është në rregull dhe unë si fëmijë e kam vënë re, por shumë mirë më kujtohet sa herë që kemi ardhur në Beograd për pushime verore apo dimërore, sepse këtu e kemi pjesën dërmuese të familjës së ngushtë dhe të gjerë dhe jashtë vendit e tjera, më kujtohen reagimet e njerëzve, ata shumë negativisht e kanë parë atë që ndodhte në Kosovë se sa ne që kemi jetuar atje 'poshtë'¹. Pasi që jeta e përditshme i ka përfshi edhe anët e këqija edhe të mira. Kryesisht, mediat bartin vetëm atë më të keqen, atë më të zezën, atë që po ndodhë në Kosovë. Prishtina ishte qyteti i cili

¹ Poshtë, është formë derogative si i referohet Kosovës.

ka pasë një popullsi substanciale serbe dhe natyrisht pjesa dërmuese ishte e përfaqësuar nga popullsia shqiptare dhe unë që nga fëmijëria ime e kujtoj si një bashkësi shumë-kulturore, sepse së pari në ndërtesën në të cilën kemi banuar me të vërtetë dominonte popullsia shqiptare, familje shqiptare dhe disa banesa ku kanë jetuar familje serbe. Kështu që, unë shoqërohesha në oborr me... nuk ka pasë ndonjëfarë dallimi në mes të fëmijëve serb dhe shqiptar. Natyrisht, gjuha paraqitej si pengesë, por ekzistojnë shumë lojëra ku gjuha as që nevojitet (e pakupt.) direkt nuk komunikoni, nuk ishte e nevojshme. Kështu që, unë atë farë lloj periudhe prej tri vjetësh deri në gjashtë apo shtatë e kujtoj si periudhë pozitive.

Tek më vonë si politikolog, si një njeri që ligjëron marrëdhëniet serbo-shqiptare, ajo çfarë ndodhi në Kosovë, po e hulumtoj dimensionin politiko-shoqëror të të gjithave që ndodhen përgjatë viteve të '90-ta dhe po i lexoj një numër të madh të hulumtuesve të cilët flasin për shoqërinë e ndarë, bie fjala një aparteid të bashkësisë shqiptare, si ata nuk kishin të drejtë të shkollohen, si ata janë përjashtuar nga puna e të tjera. Ne në anën tjetër, ne, njerëzit që kemi jetuar atje shohim një tjetër dimension dhe mendoj që nuk ka qenë ashtu bash bardh e zi. E vërtetë që me ardhjen e Milosheviqit vjen deri te një numër i madh i ndryshimeve të situatës politike, për atë se autonomia në masë të madhe u zvogëluar, por edhe këtë serbët e kanë konsideruar si... sipas atij tregimit nga fëmijëria ime e tjera, se nuk është një situatë normale që Serbia si Republikë në Jugosllavi e cila i ka dy krahina autonome dhe ato dy krahina autonome mund të votojnë në kuvend për diçka që i takon Serbisë qendrore se deputetët nga kjo Serbi qendrore mund të pyeten se çka po ndodhë në Vojvodinë dhe në Kosovë. Këtë kushdo që e shikon, kjo vërtete ishte një situatë e çuditshme.

Por kjo e ka marrë një reagim i cili ishte i pritur, që do të thotë, kur mundësoni një shkallë të autonomisë, atëherë është shumë e vështirë kur merren të gjitha të drejtat e mundshme dhe natyrisht që ka ardhur deri te një lloj rebelimi i përfaqësuesve shqiptarë. E unë këtë si fëmijë, tani do kthehem, e kam përjetuar përmes disa pamjeve të prindërve të fëmijëve me të cilët jam shoqëruar, "Ai është Serb, ruaju!" E të tjera. Pastaj, dhe përsëri shikuar nga ana tjetër unë kam hasur në njerëz shumë pozitiv të cilët fare nuk e kanë parë dallimin as në anën e shqiptarëve as në anën e serbëve, kështu që nuk është krejt bardhë e zi, po.

Marijana Toma: Na thuaj, ju në cilën pjesë të Prishtinës jeni rritur?

Stefan Surlic: Ajo pjesë është shumë e madhe, quhet Dardania, që do të thotë unë kam qenë afër qendrës tregtare "Kurrizi", edhe pse unë nga njëra anë në fillim të fëmijërisë jam rritur, pastaj ne jemi transferuar në një pjesë tjetër, e cila ka qenë afër ndërtesës së Elektro ekonomisë apo si quhej në popull "Lepa Brena", dhe sot e kësaj dite ashtu e quajnë. Kjo pjesë është tani afër katedrales katolike të cilën e kanë ndërtuar, ajo i kushtohet Nënë Terezës.

Marijana Toma: A është kjo qendra e Prishtinës?

Stefan Surlic: Po.

Marijana Toma: E në cilën shkollë ke qenë?

Stefan Surlic: Shkolla ime tani quhet "Dardania", ajo është afër Ngrohtorës në Prishtinë dhe afër qendrës tregtare "Kurrizi", me herët quhej ndryshe, së pari "Lenini" e më vonë "Miloš Crnjanski", do të

thotë, kur u regjistrova unë në shkollë, në atë kohë u ndërrua emri, që do të thotë më nuk ishte “Lenini” por shkolla quhej “Miloš Crnjanski”.

Marijana Toma: A të kujton diçka ajo shkollë, a ke qenë në shkollë aty ku ka pasë paralele të përziera apo në atë kohë fëmijët mësonin në dy gjuhë?

Stefan Surlic: Jo, atëherë veç ishte, ajo të cilën e kujtoj në të vërtetë, shkolla ishte e ndarë, ashtu saktësisht dihej pjesa e serbëve dhe e shqiptarëve, edhe hyrjet kanë qenë të ndryshme. Ja kështu ishte deri në fillim të luftës. Ne e kemi pasë një oborr qendror në të vërtetë, në oborr dhe nuk do e harroj një kohë të gjatë një imazh, vërtetë në fillim të vitit ‘99, kur nuk dihej akoma nëse do vijë deri te bombardimi apo jo dhe aty ishte një atmosferë e tensionuar që edhe ne fëmijët e kemi vërejtur sepse vërtet ka qenë...Misioni i OSBE-së, marrëveshjet dhe të gjitha me radhë, çka do të ndodhë, sulmet e shpeshta të UÇK-së në të gjitha pjesët e Kosovës, Prishtina kishte mbetur si një pjesë gati e ndarë në mes, ishte vetëm ajo. Ne e kemi pa, më kujtohet si fëmijë me prindër të mi në lajme, ditari, “Hyri UÇK-ja në Rahovec”, vend i cili ishte krejt disa dhjetëra kilometra larg Prishtinës.

Do të thotë, një situatë ashtu e cila nuk i përket normales, shumë shpesh bombardohej, sulmet në Prishtinë dhe kjo ndodhi në përdhësë të ndërtesës tonë. Dhe kthehem te ky imazh nga shkolla, ndodhi dikur në shkurt të vitit ‘99, ne mund ta shihnim njëri tjetrin nga dritaret, ne në njërën anë, ata në anën tjetër dhe e di që të gjithë ne fëmijët i kemi mbajtur tre gishta naltë ndërsa ata dy gishta. Dhe vetëm jemi shikuar, ka qenë [imazh] i palëvizshëm, askund nuk kishte ndonjë kërcenim, asnjigjë, një heshtje, dhe ai përjetim përmes atyre xhamave. Dhe ky është një imazh që do të mbetet me mua përgjithmonë, pra ajo heshtje, pa asnjë reagim emocional, vetëm gishtat e ngritur dhe një vijë ndarëse e cila atëherë më është dukur, dhe me kohë po duket e pakapërcyeshme dhe e cila është bartur edhe tek më të rinjtë.

Marijana Toma: Po ti sa vjeçar ishe atëherë?

Stefan Surlic: Në vitin ‘99, unë i kisha dhjetë vjet, saktësisht më kujtohet, po. Më kujtohet, kjo mua shumë më ka penguar dhe sot e kësaj dite kur shkoj në Prishtinë dhe bisedoj se pse ata e kanë pasë sistemin paralel të edukimit, ku ishin nëpër disa shkolla të improvizuara, në shtëpia, në podrume kanë mësuar. Nuk e kundërshtoj këtë sepse kështu ishte, por prapë duhet pasur parasysh që një pjesë e madhe e popullsisë së Kosovës ishte në pjesët rurale, kështu që edhe më herët shkollat ishin nëpër shtëpia e tjera, në shtëpia kulture.

Më kujtohet përgjatë gjithë kësaj periudhe, duke e llogaritur edhe vitin ‘99, se shkolla ka qenë e ndarë qartë, se fëmijët do të thotë të nacionalitetit serb dhe shqiptarë kanë shkuar në institucione zyrtare, do të thotë nuk kishte asnjë lloj improvizimi, dhe madje deri ‘98, pasi që drejtori dhe drejtorja nuk kishin organizuar të kemi furrë përgjatë kohës së pushimit të gjatë, ne kemi shkuar në anën e shqiptarëve sepse ata i kishin furrat e përparuara dhe ne kemi shkuar aty...

Neve na lejohej, ka qenë një derë përmes të cilës ke pasë mundësi të kalosh lirisht, dhe atje në furrë kemi blerë ndonjë gjë sa për pushim të gjatë, do të thotë në furrat e shqiptarëve dhe nuk kishte kurrfarë problemi. Do të thotë aty ishin fëmijët e serbëve dhe të shqiptarëve, njësoj. Deri ‘99, kur erdhi deri te përlëshja fizike e të rriturve, klasa e shtatë dhe e tetë. Shqiptarët dhe serbët takoheshin te dera,

u kuptua se do ketë probleme, rrahje, në atë rast drejtorët e të dy anëve të shkollës vendosën për ta mbyllur derën dhe fëmijët të mos kenë më kontakt.

Marijana Toma: Në të vërtetë, kur ti i kujton vitet e para të shkollës tënde, në princip, fëmijët nuk vinin në kontakt me njëri tjetrin, mendoj përveç në atë rast, eventualisht në shtëpi, në ndonjë oborr të përbashkët, ndërtesë etj.?

Stefan Surlic: Po, ndonjë lloj kontakti direkt nuk kemi pasë, po themi, ishte pengesë e madhe gjuha dhe jo vetëm ajo. Kur i shikon njeriu disa popuj shumë të zhvilluar të Evropës, të cilët jetojnë njëri pranë tjetrit, të cilët kanë edhe monarki të përbashkët e tjera, dhe kërkojnë disa të drejta të veta të posaçme. Në Ballkan ka kaq shumë dallime, domethënë serbët dhe shqiptarët dy botëra të ndryshme, në pikëpamje religjioni, etnive dhe në pikëpamje kulturore, dhe prapë se prapë ka shumë shembuj pozitiv të miqësisë së ndërsjellë dhe martesë të përzierë dhe mjaft pak flitet për këtë. Po i bie se serbët dhe shqiptarët absolutisht nuk kanë pasë kurrfarë komunikimi, sikur të kishin qenë gjithmonë në luftë, të përçarë, dhe që këtu asnjë tregim pozitiv nuk ka në marrëdhëniet ndëretnike.

Marijana Toma: A të kujtohen ndoshta ato tregime pozitive, a din ti diçka nga vetë rrethi i yt apo?

Stefan Surlic: Më kujtohen, natyrisht. Nga vet shembulli i familjes sime. Domethënë, babai im pas punës së tij në firmë shoqërore e hapi një firmë private, ajo ka qenë e vetmja firmë shumëkombëshe, që do të thotë kanë punuar serbët dhe shqiptarët, dhe atëherë shumë njerëz i thoshin babait tim, “Pse, pse?” e kështu me radhë, por mu më kujtohet ai reagimi i tij, sikur, “Mua më duhen punëtorë të mirë, kërkoj mjeshtër të mirë, nëse dikush është më i miri në punën e tij, absolutisht në asnjë moment nuk më intereson a është serb apo shqiptar”. Por këto kanë qenë shembuj të rrallë që dikush të jetë i gatshëm për të organizuar diçka të tillë, por unë e kujtoj, me babën tim kam shkuar shpesh në teren, se si ata tepër mirë kanë bashkëpunuar, punonin punët e përbashkëta, bile më shumë kishin probleme në mes veti serbët, dhe shqiptarët në mes veti, se sa që kishin në mes nacionaliteteve të ndryshme. Shembuj pozitiv gjithashtu gjej në atë se gjatë ditës në banesën tonë janë mbledhur gjithmonë elita e serbëve dhe shqiptarëve dhe njerëzit kanë shikuar prapë se prapë më racionalisht atë deti të pakuptimtë në të cilin ndodheshin dhe kjo situatë nuk i shkonte për shtati as njëres e as tjetrës palë.

Marijana Toma: Çka bënin prindërit tu?

Stefan Surlic: Nëna ime ka punuar në Këshillin Ekzekutiv, ajo ishte anëtare e Këshillit Ekzekutiv në Krahinën Autonome, ndërsa baba ka punuar në disa vende të punës, vendi i fundit i punës përpara se të kalonte në firmën private “Robotika”, punonte në fabrikën e amortizuesve, e cila gjendej mes Prishtinës dhe Fushë Kosovës. Mendoj është e njohur fabrika amortizuesve, në kohën e ish-Jugosllavisë, mendoj se kanë punuar amortizime për “Pezhonë” [Peugeot] e të tjera, po, po, atë. Edhe sot dikush thotë, “Aha! E di, aty afër Prishtinës ka qenë ajo fabrika e madhe, e cila i ka punësuar disa mija njerëz.”

Marijana Toma: A janë prindërit me origjinë nga Kosova, a janë ata të lindur në Kosovë apo janë të ardhur?

Stefan Surlic: Jo. Jo, është një situatë mjaft specifike. Në të vërtetë prindërit e mi janë kolonist nga Lika, të ardhur në Kosovë, ndërsa nëna ime rrjedh nga një martesë e përzier, gjyshja ime ka qenë

Austriake, ndërsa gjyshi ishte Beogradas. E këtu është tregimi i gjatë, do të na duhej edhe një orë apo dy për ta shpjeguar se si ishte...

Marijana Toma: A mundeni në pika të shkurta?

Stefan Surlić: Shkurt, po, gjyshi im ka qenë në luftë dhe e kanë zënë rob luftime në Gjermani pas Luftës së Dytë Botërore. Prindërit e mi janë gjeneratë mjaft e vjetër, pra të viteve '46 dhe '50, njerëzit e tyre domethënë, gjyshja dhe gjyshi kanë qenë diku të viteve '14, '17 deri '26, '27-tës të shekullit XX, kështu që ata e mbajnë në mend shumë mirë Luftën e Dytë Botërore dhe aty gjyshi im e ka njohur gjyshen time Austriake në Salzburg, ndaj aty është ndalë për të jetuar.

Pastaj, ata ishin një familje pro-monarkiste, familje e vjetër beogradase kanë jetuar në Dedinje të gjithë. Një vëlla ka qenë komunist, mirëpo, më pas çfarë ndodhi në vitin '45, ai vëlla nuk ka dashtë të marrë pjesë në ato ngjarjet që ndodhnin këtu në Beograd, edhe pse ka qenë komunist i përbetuar i Luftës së Dytë Botërore, pastaj si një dënim partiak, mbase e caktojnë si komisar në Prishtinë. Dhe kështu, diku rreth viteve të '50-ta, para vdekjes ka kërkuar që ta shoh edhe një herë vëllaun dhe pastaj sipas nënës, do të thotë, gjyshi im me gjyshen Austriake erdhën nga Salzburgu në Beograd. Që nga ajo kohë e ka marrë një këshillë që të mos jetoj në Beograd, sepse UDB-a² e kishte përcjellur deri në kufi, dhe ka pasur të vijë edhe deri te likuidimi i tij e tjera, tjera. Megjithatë, duke ju falënderuar këtij vëllai të dytë shpëtoi dhe mori këshillën që të shkoj të jetoj në Prishtinë, aty ku ishte edhe vëllai i tij. Vëllai i tij pas një kohe të shkurtër vdes, ndërsa ata kanë ngel atje dhe kështu.

Kështu, i kujtoj vetëm tregimet e gjyshes sime Austriake që thoshte, e pyeta unë, “Si ishte gjatë viteve '50-ta, '60-ta, ti nga një vend si Salzburgu, i cili është aq i bukur e të vijsh në Prishtinë?” Ajo tha se struktura e popullsisë u ndërrua dukshëm, dhe se në të vërtetë Prishtina ishte një kasaba turke, në të vërtetë më së shumti ka pasë turq dhe familjet e vjetra të bejlerëve të cilat më vonë sipas një lloj programi në të '60-tat në masë të madhe kanë shkuar në Turqi dhe mbeten një numër i vogël i banorëve serb, shqiptar. Ka dalë në një fustan të jashtëzakonshëm në rrugët e Prishtinës dhe shkon deri në treg dhe në atë kohë kur të gjitha gratë ishin të veshura në dimia, me shamia dhe se ajo dukej në mes tyre shumë e çuditshme prandaj ata filluan ta preknin dhe sikur mos të ishte policia e qytetit dhe ta shpëtonte, thoshte, “Unë vërtete kam qenë e çuditur, aty ishte vërtetë një ndeshje e civilizimeve të asaj kohe.”

Ndërsa nga ana e babait, ata janë nga Lika, kanë ardhur nga Lika në valë të shumta, që do të thotë, janë vitet '20-ta dhe '30-ta, menjëherë pas Luftës së Parë Botërore dhe atëherë vendi u nda, do të thotë sidomos atyre që kanë marrë pjesë në Luftën e Parë Botërore. Ja këtu kishte qenë njëfarë momenti i ‘tokës së shejtë’ ku të gjithë u kujtuan që ata janë nga Kosova dhe para qindra e qindra vitesh kishin ardhur nga Lika dhe tani në të vërtetë është një lloj kthimi atje nga kanë ardhur, a ishin ato në krahët e malazezëve apo të kosovarëve por kështu ishte. Kryesisht ato vende, si Fushë Kosova, rrethi i Lipjanit, ka shumë fshatra dhe vende ku kanë jetuar njerëzit nga Lika, Hercegovina, Mali i zi.

Marijana Toma: Interesant. Ndërsa prindërit kanë studiuar që të dytë në Prishtinë dhe aty janë njoftuar?

²Uprava državne bezbednosti (UDB), Drejtoria e Sigurisë Shtetërore.

Stefan Surlic: Jo. Jo, do të thotë, nëna ime ka studiuar në Beograd dhe Prishtinë, ndërsa babai ka studiuar në Novi Sad. Kështu që, edhe një herë janë përcaktuar për t'u kthyer, dhe të jetojnë në... në Prishtinë.

Marijana Toma: E çka është, a keni biseduar ndonjëherë me prindërit e tu, çka është te ata, mendoj, tani thjeshtë, unë po nisem nga një pozicion tjetër, çka ka ndikuar në ata që u kthyen pas studimeve të tyre në Beograd dhe Novi Sad, dhe vendosën të kthehen në Prishtinë?

Stefan Surlic: Mendoj se vendimtar ishte ai momenti familjar, sepse prindërit tani më i kishin këtu 'poshtë', dhe domethënë, dhe mendoj se sa i përket babait ka pasë ai mundësi të mëdha për punësim sepse ai në të vërtetë filloi punën, edhe pse ai ishte gjeneratë e '46, tani nuk e di saktësisht me faktografi që t'u tregoj, por viteve të '60-ta, por ai ishte njeri që përfundoi shkollën e mesme teknike, filloi të punonte në fabrikë si bursist i fabrikës shkoi për të studiuar për Makineri. Kështu që, ai në njëfarë mënyre ishte i obliguar që të kthehej, më pas edhe ka ndërruar vende të punës për sa e di unë, mirëpo ai gjithnjë ka qenë i përcaktuar për të jetuar në Kosovë.

Nëna e ime në të vërtetë gjithmonë ka qenë kundër dhe gjithnjë i ka përsëritur fjalët e babait të saj se nga ai qytet dhe nga Kosova duhet ikur me mija kilometra sepse atje nuk ka jetë normale dhe se atje gjithmonë do të ketë luftëra dhe mospajtime, dhe kështu ajo fliste gjatë gjithë kohës në fëmijërinë time, më kujtohen ato fjalë të saja dhe babai i thoshte që... Mirëpo, vetëm gjyshja Austriake për shembull ishte në anën tjetër, sa herë që nëna ime theksonte këtë dëshirë, "Hajde të shkojmë në Beograd, hajde në Novi Sad," hajde gjatë gjithë viteve '90-ta, "se këtu nuk ka jetë". Aty gjithmonë gjyshja ime ka thënë, "Unë një herë jam shpërngulur dhe mua mos m'i luani këta eshtra të vjetër" (...) "si të shpërngulem nga Prishtina." Kështu që...

Marijana Toma: Dhe çfarë të kujton ajo periudhë, do të thotë kjo kur thua të '90-tat, dhe ajo kur nëna e juaj i kujton fjalët e gjyshit, a ishte, nuk e di, e di që në një moment në vitet '95 kur erdhën një grup i njerëzve të cilët kishin ikur nga *Oluja*³ dhe erdhën, erdhën në Kosovë, a kanë pasur jehonë mospajtimet e jugut, të cilat mbase i kujton ti si fëmijë, edhe pse ndoshta atëherë ke qenë mjaft i vogël?

Stefan Surlic: Më kujtohen. Ishte një jehonë e madhe e sidomos popullsia që vinte nga ato anë, së bashku me babën tim dhe disa familjarë në kontakt me të tjerë, dhe atë kohe nuk kishte shumë telefoni të zhvilluar ishte mes i luftës, as internet, asnjë gjë, kështu që, më kujtohet pas akcionit *Oluja*, '95-ta, ishte çështje se kush ka mbijetuar, kush ka arritë në Serbi, dhe shumë shpejt janë organizuar. Një numër i madh i familjeve janë vendosur në Kosove, gjatë viteve '90, do të thotë vitet '95 dhe '96. Babai im e formoi një lloj organizatë jo formale, që të ndihmohen ata njerëz, të punësohen, që të mbesin aty dhe të bëjnë jetë normale.

Ata ishin të vendosur në sallën e sporteve dhe më kujtohet që shkova me të dhe më duket që ishte një skenë ndër më të hidhurat, ku të gjitha familjet së bashku banonin në disa dyshekë të pazakonshëm, të shtrirë, plotësisht pa kurrfarë mjetes, pa mjete financiare, atyre ju kishin lëshuar vetëm sallën e sporteve, e dimri afrohej. Një gjendje e pabesueshme dhe duhej që sa më parë të ju gjendej disi një

³ *Oluja* është emri i operacionit ushtarak kroat dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kroacisë, e cila u realizua në gusht, 1995, me qëllim të shkatrrimit të regjionit të Republikës Serbe. 200 mijë deri në 250 mijë janë dëbuar nga Kroacia.

akomodim normal. Eh, një kohë të gjatë disa njerëz të vjetër kanë jetuar në baraka në disa vende të improvizuara.

Pastaj shumë nga ata kanë shkuar, ishin disa programe të shpërnguljes për në SHBA dhe Australi dhe ata njerëz edhe sot lajmërohen, i lajmërohen babës tim e kështu.... Më kujtohet që një grua erdh dhe i tha babës tim, sikur, “Më falni, unë nuk kam për buke, a keni mundësi të më ndihmoni të më jepni diçka?” Më duket ishin nja 50 dinarë, e di në foto ai Milosh Obrenoviqi i kaltër, s’e di a ishte 50-she apo diçka e ngjashme, por e di që baba i nxori e ia dha, kjo ishte një banknotë dhe ajo e falënderoi deri, deri, deri në qiell, kjo është.... Më kujtohet kjo si fëmije i kam këto imazhe dhe skena, tani mbase tingëllojnë si banale dhe baba e solli një shishe të rakisë e kishte një dozë depresioni nga kjo skenë edhe disa kilogram suxhuk dhe kur hyri në atë sallë u tha, “Ku jeni njerëz, si jeni?” Kur e panë ata përnjëherë u afruan, e rrethuan, të gjithë donin ta merrnin nga një gotë dhe një copë suxhuk, e kishin një lloj djathi edhe suxhuku dhe për një çast u kthye një atmosferë pozitive sepse edhe ata e hetuan se nuk janë të lënë pas dore.

Por ekzistonte një lloj rezistence nga ana e shqiptarëve, më kujtohet se te ata ishte shtjelluar një lloj, si lloj akti që përsëri do vijë kolonistat, se ata po e sjellin një gjuhë që ata nuk e njohin, pastaj ata [refugjatët] ishin refuzuar nga shitja e mallit nga ana e shitëseve, për shembull kur ata thonin, “*Kruh*” [bukë] apo diçka të ngjashme, kjo ishte fjala të cilën nuk e kuptonin, çfarë do të thotë? E kështu ishte, ja këto më kujtohen. Por e di që shumë shpejt ato familje kanë ikur, apo gjetën strehim në Serbi, apo diku në rrethin e Beogradit, ata të cilët ishin të organizuar apo në ato programe, shumica e tyre janë në Australi, Amerikë edhe sot.

Marijana Toma: Na thuaj tani, ti ke shkuar në shkollë ‘86-tën, ‘96-tën apo jo?

Stefan Surlic: ‘96.

Marijana Toma: ‘96-tën?

Stefan Surlic: Në të vërtetë më herët, ‘95. Unë fillova të shkoj në shkollë kur i kisha vetëm gjashtë vjet.

Marijana Toma: Dhe ti në fakt, kur filloi lufta në Kosovë, në cilën klasë ishe?

Stefan Surlic: Po mirë, kur filluan konfliktet, më intensive ishin gjatë ‘97-tës. Mua më kujtohet ajo frika ime që duheshim të ikim jashtë Prishtinës, madje edhe sikur do të ishte fjala për ndonjë vikend apo të ishte fjala për shtëpinë e fshatit të cilën e kemi pasë, e cila gjendet në rrethin e Lipjanit dhe gjithnjë e kam pyetur babën, “A kanë mbërri terroristët?” Në kuptimin se, a jemi ne të sigurtë. Baba më thoshte, “Mos u brengos bir, ka edhe polici, ushtria po e ruan rendin, nuk do të ndodhë asnjëgjë.” “Si nuk do të ndodhë asnjëgjë, shiko neve po na lajmërojnë kështu, lajmërojnë ashtu?” Pastaj tregimet e atyre njerëzve që ishin si rezervistë të rinjë të cilët kishin qenë në Koshare dhe në përgjithësi rreth kufirit të Drenicës.

Pastaj, një herë baba ishte i detyruar që të shkojë në Pejë, poashtu jemi frikësuar shumë për të deri në orët e vona të natës, sepse rrugët ishin të bllokuara plotësisht. Njësitë e UÇK-së nxjerrnin njerëz nga vetura, i vranin dhe më kujtohet një dhe shumë raste tjera kështu, kur mendoj babi vinte në shtëpi apo nëna dhe tregonte, “A e dini se kënd e kanë vra, a e dini?” Dhe kështu dikush ashtu dikush kryesisht.... Njeriu është një krijesë e çuditshme, i pranon disa gjëra si normale e adapton vetën shumë shpejt

edhe në situata jo normale. Tash kur i tregoj dikujt më thonë, “Kur keni ndëgju se dikush është vra, pse nuk u paketojshnit dhe aq?” Jo, atëherë vetë fakti se ne jetonim aty ndikonte, e shoh edhe tani kur i përcjell disa ngjarje në botë, pyetem se si mund të jetojnë këta njerëz, nuk e di në Siri, në Palestinë, edhe pse çdo ditë e kanë ndonjë sulm me bomba, kanë shumë të krisura, thjeshtë njëherë njeriu e pranon këtë si dukuri normale të jetës ndaj nuk e refuzon deri në fund derisa sa të ballafaqohet me më të keqin moment dhe nuk ndërmerr as edhe një hap.

Deri në çastet e fundit, prindërit e mi kanë qenë të bindur se nuk do ketë asnjë nga bombardimet, se askush në Evropë e as në Amerikë nuk do të kujtohet që të bombardoj në këtë mënyrë një shtet të tërë dhe të shkaktoj aq shumë viktima, dhe prapë Milosheviqin e rrëzoi vetë popullin i vet dhe jo bombardimet e NATO-s, muaj më vonë. Mirë, unë tani po e fus një moment nga politika, por vërtet më kujtohet një moment i 24 marsit [1999] dhe ajo natë, ne nuk kemi pasë asnjë rezerve në shtëpi, rryma u ndal, më pas u ndal edhe uji, kur u dëgjuan eksplodimet. Atëherë, meqë nëna ime i flet shumë mirë disa gjuhë të huaja, sidomos në *RTL*, gjermanisht dhe kanale tjera, në gjermanisht kur i ka përcjell, aty lajmëruan se janë nisur nga Aviana [Itali] avionët e trupave të NATO-s, trupat nga Shqipëria dhe Maqedonia po nisen për në Kosovë dhe se kursesi nuk ishte i përjashtuar opsioni i ofanzivës tokësore. Eh më në fund prindërit e mi e kuptuan se aty është fundi, dhe atyre u nevojiten vetëm disa orë që të mbërrijnë nga rrethi i Kumanovës, Tetovës dhe t’i shohim në Prishtinë dhe aty të fillojë lufta e përgjithshme dhe askush mos të nxjerrë kokën e vet shëndosh. Baba im tha, “Me më pas thanë dikush në atë moment, atë natë, pasi isha plotësisht i papërgatitur, të më ofrojë dhe të më thotë, krejt çka keni nga pasuria, nga më të vlefshmet, krejt çka keni të m’i jepni mua, ndërsa ne ua dërgojmë fëmijët në një vend të sigurt, do të mbërrijnë në Beograd, unë do ta kisha nënshkruar dhe do të ju kisha thënë shkoni.” Sepse kjo në të vërtetë në një moment, në atë erupcion paniku dhe frike se vetëm më të këqijat mund t’i presim në orët në vijim.

Por të kthehem më herët, kjo periudhë e ‘90-tave, po them ndihej ajo lloj atmosfere, por gjithmonë ka pasë disa shembuj pozitiv. Mirëpo, unë i kujtoj ato masa në protesta dhe vetëm ‘97-’98 nuk ishim shumë të sigurt që të kthehemi nga shkolla vetëm deri në shtëpi, dhe gjithmonë ose na mblidhte mësuesja ose vinin prindërit në formë të organizuar për t’i përcjellur fëmijët, sidomos nëse udhëtojnë në këmbë. Madje edhe grupe të ndryshme fëmijësh e pritshin njëri-tjetrin, serb dhe shqiptarë, sakt dihej se kush kthehej nga shkolla dhe tani mundet dikush të ndërhyj, prandaj gjithmonë kemi qenë në njëfarë gjendje gadishmërie, që ndonjë rrahje mes fëmijëve mund të ndodhë, por prapë se prapë flitej se si politika reflekton në të gjitha anëtarët e shoqërisë, duke i përfshirë edhe fëmijët.

Tjetra që njëkohësisht ishte e çuditshme dhe tani mund të tingëllojë raciste dhe shoviniste, por në ditët e sotshme nëse e pyet ndonjë serb apo shqiptar, ata do të tregojnë se i njohin sipas fytyrës se kush është serb e kush është shqiptar. E vërtet, kjo ka ndodhur, unë e kujtoj shokun tim i cili ka jetuar në një skaj dhe i cili ka qenë bash ashtu plotësisht si shqiptar, etnikisht, ai me luti mua që ta përcjelli, të shkojmë së bashku, sepse do ta njohin që nuk është Serb. Sipas fizionomisë, edhe sot nuk e di por serbët dhe shqiptarët të dy palët e kanë njohur njeri tjetrin. Pa, pa ndonjë fjalë. E kjo ishte situata para luftës pastaj paraqitej ajo frika se do na njohin që jemi, që jemi serb. Apo po, më kujtohet se si disa prej shokëve të mi të cilët shihnin disa njerëz të cilët ishin shqiptarë dhe donin që t’ua hedhnin, tamam e kanë pasur të kjiartë që ata janë shqiptarë, hajde sikur ne po ua hedhim ndonjë, por...

Marijana Toma: Këto në të vërtetë, do të thotë se në mbarë shoqërinë, madje edhe fëmijët duket se kanë marrë pjesë, jo në përlëshje fizike, por është reflektuar në ta.

Stefan Surlic: Po, po.

Marijana Toma: E më thuaj tani, kur ti e fillove tregimin, e the se ishe me prindërit kur filluan bombardimet? Ju gjatë gjithë kohës ishit në Prishtinë deri sa kishte bombardime, apo?

Stefan Surlic: Jo. Do të thotë, të nesërmen nëna ime, meqë punonte në Këshillin Ekzekutiv erdhi dhe tha, “E kuptova se ushtria po vjen kah Mitrovica dhe ajo rrugë është e lirë.” Edhe më tutje ishte opsioni i intervenimit tokësor, pastaj ndodhi që baba im, pasi që ishte i lindur të ‘46-tave dhe se nuk kishte qenë fare i detyruar të shkoj në ushtri, ai ishte i ashtuquajtur *trećepozivac*⁴ siç quhej atëherë, madje edhe në dekadën e pestë dhe të gjashtë të jetës së tij, ky të dalë nga, gjegjësisht që ne të dalim së paku deri në Mitrovicë të Kosovës dhe ta lëshojmë Kosovën, sepse ishte vendosur që të mos rrijmë në Kosovë sepse do të pëlças lufta e përgjithshme, ndërsa nëna e cila punonte në institucione shtetërore ajo tha, “Unë do të qëndroj këtu, pasi që unë i flas gjuhët.” Tjetra, nëna ime i ka pasë edhe nofka si “*Pravda*”, [Drejtësi] meqë ajo punonte në sektorin e drejtësisë dhe sipas nënës së saj austriane, “*Nemica*”, “*Švabica*”, [Gjermanja] e çka jo tjetër. Ajo ka mendu se si e tillë nuk do të jetë e ngacmuar e dëmtuar as nga fqinjët shqiptarë, ndërsa me të huajt mundet të flas gjuhën gjermane, frënge dhe angleze, kështu thoshte ajo, “Unë do të qëndroj këtu për ta ruajtur pasurinë”, sepse e gjithë çfarë kishim ishte banesa, dhe ato që i kishim ishin në banesë, kjo është kjo.

Kështu që, ne me gjësendet elementare ikëm nga Kosova, me disa valixhe të vogla, torba, si më kujtohet e kam pasë një atlas gjeografik, në atë kohë kisha dëshirë shumë për të shikuar atlasin e gjeografisë prandaj e mora me vete edhe motra disa libra dhe këto, në të vërtetë me këto gjëra ne e lëshuam Kosovën dhe nuk kemi ardhur deri te ajo vizita jo formale, unë mendoj se ishte viti i 2004. Viti i pestë.

Marijana Toma: Eh, a mundesh tani të më tregosh diçka për atë ikjen tuaj, si dukej, thjeshtë kur shikon këtë nga perspektiva e fëmijës, si dukej ai rrugëtim, ajo ushtria?

Stefan Surlic: Ajo ishte njëra nga skenat më skandaloze prej atyre që unë i mbajë në mend, e pahijshme edhe në ditën e sotme, babai i im tha, “U plaka për pesë vjet gjatë këtij udhëtimi nga Prishtina deri në Mitrovicë të Kosovës.” Sepse nuk kishte, ushtria kishte kaluar, asnjë veturë nuk ishte në këtë rrugë, në asnjërin drejtim. Fshatrat shqiptare e serbe, plotësisht të zbrazura, dyert krejtësisht të hapura, domethënë, sikur të ishte një kamerë të xhironte, krejtësisht si në filmat më të tmerrshëm kur ndodhë diçka katastrofike dhe askund nuk mbetë një frymë e gjallë.

Pra, ai hap i tërë deri në Mitrovicë, absolutisht ka qenë i shkretë e i zbrazët, meqë ne e kishim një veturë të vjetër gjysmake, baba vetëm kishte frikë mos po ndodhë diçka dhe po na lenë në këtë shëmti, ai i vetëm me dy fëmijë adoleshentë edhe kjo ishte kështu. Tek kur kemi mbërri, do të thotë kur e kaluam pjesën jugore të Mitrovicës dhe fabrikat, baba tha, “Mirë është, ne kemi mbërri.” Eh pastaj ishte më lehtë, nga Mitrovica në Rashkë, dhe aty ne ndaluam.

⁴ Anëtarët më të vjetër që i kanë takuar pjesës rezerviste të ushtrisë së Jugosllavisë.

Këtu është një vend i vogël, Brvenik të Rashkës, i cili pas bombardimeve, ne kemi dalë nga rrënimet, sepse gjatë bombardimeve nuk ishte sigurt që të udhëtojmë më tutje, do të thotë e lëshuam Kosovën por hajde të qëndrojmë këtu diku të shikojmë dhe tani po ashtu, si po e shohim të gjithë, elitat politike mendonin se bombardimet do të zgjatë disa ditë në tanësi, nuk do të zgjatë aq shumë. Hajde sikur do të kaloj ky bombardim, do të qetësohet, e lëshuam Kosovën ta shohim mos ndoshta do të vinte deri te konflikti, deri te konflikti direkt në terren, nëse nuk ndodhë, ne duhet të kthehemi. Mirëpo, ne ishim në Brvenik dhe në vështirësi, në të zbardhur mëngjesi me datën 6 prill, ranë bombat, përkatësisht raketa ne urën e Brvenikut, një urë e thjeshtë e cila të çonë në fshat poshtë por edhe deri te binaret, e cila në vijën ajrore prej atij moteli ishte gjithsej 20 metra, kështu ne ishim në një gjysmë rrënojë dhe ikëm nga ato dhoma dhe tani saktësisht më duket ishte ora 4:00 apo 4:30 e mëngjesit.

Këtë e kujtoj, kjo ishte një traumë shumë e madhe, sepse për një moment filluan të ndahen muret, në mes të natës u zgjuam, dhe copa të suvatimi binin mbi neve. Më kujtohet se babai na përqafoi dhe pastaj ai foli, tha, “Në atë moment unë kam mendu se nëse diçka bije dhe rrënohet mbi neve, unë së paku ju kam mbrojtur që në një mënyrë në këto vende të rrënuara të mbijetoni.” Për fat u nda muri por vetëm në dy anë, dritaret e dyert të gjitha fluturuan me shpejtësi marramendëse, ndërsa ne nuk e kemi pasë asnjë grrithje prej gjithë asaj hataje e cila ndodhi, për një çudi të mrekullueshme.... Do të thotë, pastaj kemi pa, ne kemi marrë pjesë në, kjo ishte një lloj aksioni kolektiv, si asnjëherë solidariteti në mes të serbëve gjatë bombardimeve, sepse njerëzit e Rashkës, nga të gjitha anët kanë ardhur për të ndihmuar, për të pastruar e tjera. Çdo dhomë e kishte dritaren mbi shtretër, kjo ishte e vetmja dhomë ku dritarja ishte anash shtratit, prandaj kur xhamat fluturuan, nuk ranë në shtrat por anash në tavolinë dhe kjo na ka shpëtuar.

Përndryshe, sikur të ishim në ndonjërin, nën stuhinë e atyre eksplodimeve, direkt do të.... Pastaj me miliona galera të cilët ishin nga të gjitha anët, në atë dhomë ku ishim ne e dini ato kanë qenë krejtësisht me gurë, që sikur të na godisnin neve, sigurisht do të na kishin lënë të vdekur në vend. Kjo sigurisht ishte dëshire e Zotit që ne të mbijetojmë këtë dhe të dalim nga kjo rrënojë, sepse ishte rrënuara kulmi, shkallët, dhe ne dolëm si prej një katakombe, kaluam për të ikur nga ky lloj moteli, “Markov konak” ashtu quhej. Mirë më kujtohet...

Marijana Toma: Në cilën datë ka ndodhur kjo?

Stefan Surlic: Me 6 prill. 6 prill. Janë, mendoj se ka qenë njëfarë ekipe e TV, ishte ekipi i RTS⁵ për të xhiruar, ata kanë xhiruar në mbarë Serbinë, gjegjësisht nëpër Republikën Federale të Jugosllavisë atëherë kur kanë rënë bomba të... kështu.... Por më kujtohen ato gra të cilat kanë punuar në atë motel, kur erdhën duke qarë sepse ato e kishin parë nga larg që ai motel nuk është më, se aty ka ngel vetëm rrënojat, dhe e dinin se jemi vetëm ne mysafir, të vetmit në atë motel. Ato erdhën duke qarë e duke dënesur erdhën deri te rrënojat dhe kur më kanë parë mua dhe motrën, atëherë e patën një valë emocionesh, pastaj filluan të na përqafojnë me orë të tëra, e kështu ne shpëtuan.

Marijana Toma: Kjo ishte... ah, po në këtë kohë nëna ishte në Kosovë?

⁵ Radio-televizija Srbija - Radio televizioni i Serbisë.

Stefan Surlic: Po. Eh por tani, edhe kjo ndodhi, ky rast ishte shok për njerëzit e mi sepse ata e kanë pasur numrin e atij moteli që u bombardua dhe këtu u ndërprejnë të gjitha lidhjet e komunikimit, moteli u shkëput ndërsa ata përmes televizionit, gjegjësisht nëna ime dhe gjyshja të cilat kishin mbetë atje e kanë parë se u bombardua Brveniku, një vend aty afër edhe moteli, xhirimet e rrënojës tregonin se, “Akoma nuk dihet nëse ka viktima.” Dhe familjarët tonë ishin në gjendje shoku, kanë menduar se ka ndodhur ajo më e keqja. Tha nëna ime, pranë asaj që kam përjetuar dhimbje dhe shok, gjyshja e humbi veten, filloi vajin i ra të fikët, tha, “Unë edhe isha pranë këtyre mundimeve, tani duhej të merresha edhe me gjyshën.” Dhe në këtë moment nuk kanë ditur çfarë të bëjnë dhe se si të kuptojnë a jemi gjallë, nëse na ka ndodhur diçka, apo mos jemi vetëm të lënduar.

Por ne në mbrëmje mezi erdhëm deri te një numër, sepse duke ju falënderuar disa njerëzve ne arritëm në Balevc, mendoj në atë vend, aty një njeri na e dha mundësinë për të thirrur nga ai vend, e mora lidhjen, unë i pari jam lajmëruar, më kujtohet ai zëri i nënës, “Ku jeni, a jeni gjallë, çka ka, si është gjen...” i thashë, “Na shpëtuam, gjithçka është në rregull”. Pastaj ato erdhën me autobus me na pa e me u bind se me neve është çdo gjë në rregull, kanë menduar se mos po fshehim dhe po heshtim, ose mos i ka ndodhë diçka babës, dhe prapë vendosën që të kthehen, thanë... Edhe baba im mendonte se më mirë që të kthehemi në Prishtinë, sepse po bombardohej e gjithë Serbia, krejt një lloj a ishim në Prishtinë apo në ndonjë qytet tjetër, edhe pse në Prishtinë në masë më të madhe kanë hedhur bomba dhe raketa. Pastaj nëna ime e luti babën që ne të shkojmë për Mal të Zi, sepse atje kishte më pak. Ne e kishim banesën atje në Tivat, dhe të shkojmë atje.

Mirëpo e dini, po e përsëris, a e dini ku ishte arsyeja pse ne nuk vazhduam nga andej nga Rashka, ishte se ne mendonin se do të kthehemi, gjatë kohës së bombardimeve çdo urë, çdo tunel, çdo rrugë mund të jetë nën shënjestër dhe kishte rrezik në çdo çast të mbesim në mes të rrugës dhe të vdesim prej bombardimeve të NATO-s. Edhe baba ishte shumë skeptik, në të vërtetë për shkak të urave të cilat ai i dinte në Mal të Zi dhe kishte frikë mos deri sa të mbërrinim në Tivat e që është një rrugë e gjatë, mirëpo vendosem, u nisëm dhe arritëm më në fund në Mal të Zi.

Marijana Toma: Kur keni shkuar në Mal të Zi?

Stefan Surlic: Po, ne shkuam pas të 6-tit, do të thotë ishte diku 10, 11 prilli. Pas katër pesë ditësh për fat, sepse është një urë dhe një rrugë paralele e cila është bombarduar nga NATO-ja tri herë radhazi. Dhe më kujtohet që pronari i atij moteli na luti, “Dëgjoni, depoja është plot me ushqim, pije, nuk ka nevojë asgjë të paguani, të gjitha edhe ashtu kanë për t’u dëmtuar, moteli është i zbrazët, çfarë mysafirësh, rrini, këtu e keni afër Kosovën, Prishtinën, çkado që të ndodhë”, e tjera e tjera. Pastaj baba im tha, vetëm, “Si qoftë e shkruar. Hajde mos të jetë që nuk po e dëgjoj nënën dhe gruan, po nëse ju ndodhë diçka e mandej të mbes unë fajtori.” Kështu që, ne, që për fat shkuam nga ai vend i cili pastaj është bombarduar edhe tri herë.

Marijana Toma: Dhe kështu ju në prill shkuat në Tivat dhe atje tani, (e pakupt.) këtë nuk të pyeta, motra e jote, sa vjeçare është?

Stefan Surlic: Ajo është ‘84.

Marijana Toma: Ajo qenka më e vjetër se ti?

Stefan Surlic: Po.

Marijana Toma: Ju atje e keni vazhduar shkollimin, përkatësisht u regjistruat dhe si kaluat? Ju u vendoset në banesën tuaj, nëse mundeni vetëm këtë të ma shpjegoni?

Stefan Surlic: Po, po, në të vërtetë ajo banesë nuk ka qenë e paguar deri në fund kështu që ne aty filluam të paguajmë qira, ishim me pronarin për një kohë të shkurtër, pastaj u shpërngulëm e tjera e tjera, në fund ne aty u vendosem dhe vendosem që aty të qëndrojmë. Nëna ime erdhi në Tivat pas bombardimit, pasi erdhi KFOR-i në Kosovë dhe pas tërheqjes së ushtrisë [serbe].

Marijana Toma: Ajo është kthyer në Kosovë?

Stefan Surlic: Po, ajo aty mbeti. Do të thotë nëna me gjyshën sërish u kthyen në Kosovë për ta ruajtur pronën dhe nuk e lanë, s'e lëshuan banesën, kështu që ato kanë ngelur deri në fund dhe deri te ajo faza më e ligë kur me hyrjen e KFOR-it erdhën jo vetëm një grup i madh shqiptarësh, dhe jo vetëm ata që kanë jetuar në Prishtinë, por edhe ata njerëz që nuk kanë jetuar asnjëherë në Prishtinë, të cilët filluan me leva të thyejnë dyert e të gjitha shtëpive serbe, kanë vjedhë e plaçkitë. Dhe nëna thotë për kohën që ka qëndruar, pra deri në korrik-gusht, i ka përjetuar skenat më të tmerrshme me britma konstante, pushkë në mes të natës, krisma nëpër dyer, e ajo ka qëndruar me dyer nën çelës, është mbyllur plotësisht, ormanin ja ka vu derës kryesore, nuk ka dalë asnjëherë nga dera e banesës, sikur në ato filmat i ka lidhë çarçafët për rrethoja të ballkonit kështu për të pasur mundësinë të kërcej në rast të ndonjë sulmi. Dhe...

Ajo kishte vendos të qëndroj deri në fund atje, dhe baba im e ka ftuar disa herë, "Le pronën në duar të Zotit hajt se do të krijojmë prapë në jetë, nuk e kemi për të parën herë që e fillojmë jetën prej zeros. Ti je juriste, unë inxhinier, nëse nuk e gjejmë ndonjë vend të punës ani çka, edhe nëse na shkon banesa, shëndeti, e rëndësishme është të jemi ne gjallë e me shëndet, çka na duhet nëse mbesin fëmijët pa nënë, kjo do të ishte shumë më e rëndë." Kur e kemi dëgjuar herën e fundit në telefon as unë as motra as baba nuk ia kemi njohur zërin nënës sime, që do të thotë ajo ka qenë në një lloj stresi, agonie nga gjërat që i ka përjetuar gjatë kohës së mbyllur dhe në fund babi tekstualisht i tha, "Dil nga banesa sa më shpejt." Pastaj ajo me njërin prej autobusëve të fundit të Serbisë që kanë dalë nga Prishtina ka ardhur së pari deri në Rashkë, pastaj prej Rashkës deri në Tivat.

Marijana Toma: Të gjitha mbetën atje a?

Stefan Surlic: Atje mbetën të gjitha. Ne i kemi thirrur disa miq, gjegjësisht nëna ime dhe disa miq familjar shqiptarë, nëse munden të hyjnë [në banesë] dhe nëse mundet diçka të ruhet. Ajo i kishte marrë me veti albumet e fotografive, diçka për të ngelur si kujtim, ndërsa të tjerat nuk ka pasë se si t'i merr me veti, e kështu ishte.

Kështu, duke ju falënderuar disa njerëzve të mirë shqiptarë na ka mbetë ajo banesë, disa gjëra i kemi marrë më vonë, disa jo, por thjeshtë në kushte lufte njeriu mendon vetëm për të shpëtuar jetën, me qenë të gjithë numër, e për të tjerat as që të shkon mendja se çfarë mbeti nga prona dhe çfarë do të kishit shfrytëzuar.

Kemi menduar, ky dimension është shumë i rëndësishëm, të shpërngulemi në Beograd dhe nëna ime ka pasur mundësi si nëpunësit e tjerë shtetëror që t'i ndahet një banesë diku në qytetet tjera të

Serbisë, vendi i punës, mirëpo na u lajmruan të gjithë miqtë të cilët kishin qenë në Beograd, Novi Sad e Nish, na treguan se fëmijët e tyre kurrsesi nuk po mund të integrohen dhe adaptohen, sepse nëpër klasa po ju thonë ‘Shiptar’⁶, po i gjuajnë fjalë, i trajtojnë keq, u bëjnë me hile, sikur ata janë fajtor për çdo gjë.

Për shembull, behën festat e datëlindjeve, “Të gjithë jeni të ftuar, ata ‘Shiptarët’ nga Kosova nuk janë të ftuar”, e kështu me radhë. Edhe këtë bash në shkollat e Beogradit, nuk janë ato bash mjedise të vogla, kështu që... Kjo mua më ka shtyer të mendoj dhe sot e kësaj dite që ne si popull i duam territoret, por nuk i duam edhe njerëzit, kjo dukuri është vërtetuar edhe në Kroaci, në Bosnjë dhe në Kosovë. Flasim për “tokën e shenjtë” dhe për atë se ne duhet të luftojmë deri në fund. Pastaj kur ata njerëz për shkak të një politike të tillë pësojnë dhe vijnë në këto qendra prej nga ka ardhur kjo politikë dhe është krijuar kjo politikë, eh atëherë këta njerëz janë fajtorët kryesor pse kanë ndodhur të gjitha këto, pastaj ata i kanë shitur të gjitha atje, kanë ardhur me plot të holla dhe e kanë okupuar gjithë çka ka qenë e mundur të okupohet këtu, kështu që në këtë kuptim ne jemi vërtetë një komb që gjithmonë më shumë e kemi vlerësuar territorin se sa popullin e vet, prandaj në Ballkan shumë më pak ka në krahasim me popujt të cilët kanë duruar dhe kanë më pak territore, por ata e ruajnë popullin e vet pa marrë parasysh të gjithave.

Marijana Toma: Ju pra në të vërtete... dua të kthehem në Tivat sepse i kemi edhe dhjetë minuta para pauzës dhe pastaj duhet ta ndërroj kartelën.... Më trego, deri kur ju keni jetuar në Tivat?

Stefan Surlic: Në Tivat në fund kemi vendosur të jetojmë unë dhe baba, sepse motra qëndroi pak dhe shkoi në studime, në të vërtetë ajo e ka përfunduar gjimnazin në Kotor dhe më pas shkoi në studime, kështu që...

Marijana Toma: Në Beograd?

Stefan Surlic: Po, në Beograd. Kështu që, vetëm prej zorit jemi nda si familje, nëna dhe motra shin në Beograd, nëna ka punuar, motra ka studiuar, ndërsa unë vendosa të rri këtu, më pëlqen deti (ha-ha). Kështu. Tivati ishte një mjedis shumë i mirë për t’u rritur, vend i përbërë prej shumë popujve ku janë vendosur shumë herët njerëzit nga Kroacia dhe Bosnja. Banorët e Kroacisë, malazezët, serbët një mjedis shumë i përzier për të cilën nuk jam në gjendje as një moment të them asgjë negative e as që kam përjetuar ndonjë gjë negative. Dhe e dyta, politika e qeverisë se atëherëshme e Malit të Zi ishte mikpritëse ndaj të shpërngulurve, kishin organizuar edhe ndihma edhe...

Marijana Toma: Ti ke shkuar në gjimnaz në Tivat apo?

Stefan Surlic: Po, në Tivat.

Marijana Toma: Dhe si duket tani jeta jote, po e paramendoj, duke pasur parasysh që dallimi është i madh, duke pasur parasysh se si duket Prishtina, si duket Tivati, qytet bregdetar, deti?

Stefan Surlic: Po unë mendoj se në të vërtetë janë vendet në të cilat jam rritur, gjegjësisht ku unë jam lindur, ku e kam kaluar fëmijërinë dhe vendi në të cilin disi kam formuar një personalitet, pasi që u

⁶ Term derogativ ndaj shqipëtarëve të Kosovës, i cili ka pasur qëllim të krijojë dallueshmëri nga shqipëtarët e Shqipërisë.

rrita fillova të mendoj të regjistrohem në shkencat politike, për t'i shpjeguar vetëvetës si ndodhi e tëra kjo dhe kush ka ndikuar që rruga e jetës sime të jetë bash kështu. Konfliktet në Kosovë, e në anën tjetër mund të them se ishte një gjendje e një politike jo stabile në mes të marrëdhënieve të rafinuara të Serbisë dhe Malit të Zi, fushata e referendumeve, dhe në të vërtete deri te shpallja e pavarësisë së Malit të Zi jetoja në Tivat dhe pastaj do të thotë në vitin 2007 e regjistrova Fakultetin e Shkencave politike në Beograd.

Po dallimi, Prishtina si një qytet i madh, mbi 150,000 banorë para luftës, Tivati një qytet i vogël në mes të 10,000 dhe 15,000 banor, por është një qytet shumë i organizuar, i cili më ka ofruar disa aktivitete shkollore dhe jashtë shkollore, jam marrë me sport dhe me aktivitete tjera shtesë, kam shkuar në shkollë të muzikës, në radio e tjera. Vërtetë një mjedis i cili mundëson që sidomos në këtë periudhë të rritjes dhe formimit të jetosh një jetë të bukur, të qetë dhe të gjitha t'i kesh afër për pesë minuta.

Por prapë ajo ndjenja e prejardhjes do të thotë shumë, unë këtë shpesh e diskutoj me njerëz, sidomos kur dëshirojnë të shkojnë diku në botën e jashtme për të jetuar. Pa marrë parasysh se këtu në Beograd shumë sende t'i ngritin nervat, çfarë janë njerëzit, çfarë janë institucionet, tollovi në qytet, gjëra të tilla ka edhe në shumë qytete të mëdha në gjithë botën, kjo është nën një, nën dy ajo ndjenja se ti dikujt i takon, sa për të mos qenë vetëm, se këtu i kam miqtë e miqve të mi, se këtu i kam edhe shokët e fëmijërisë, këtu e kemi familjen e ngushtë dhe të gjerë, këtu e ke dikë.

Megjithatë, Mali i Zi ishte vendi në të cilin unë nuk e kisha as edhe një kushëri, madje baba im edhe të dy prindërit e mi nuk kanë pasë asnjë lloj miqësie, kolegë të punës, atje plotësisht ishte një botë e re. Se unë më lehtë e kisha që të integrohem në atë botë në krahasim me babën tim i cili ka punuar së pari si inxhinier në fabrikën "Bokeljka", pastaj si mësimdhënës në shkollë, aty ka dhëne mësim edukatë teknike, pastaj fizikë dhe matematikë, por prapë se prapë e kishte atë ndjenjën e vetmisë, sepse nuk është kjo ajo – ne atje me babën vetëm në atë vend ku nuk kishim askënd nga ata të origjinës. Edhe atë në pikëpamje të identitetit në kuptim të një forcimi të integritetit, është mjaft vështirë, ju tani posa të shkoni në një vend dhe e përjetoni këtë do ta hetoni se si jeni ju një krijesë fragjile dhe krijesë e cila nuk mundet pa bashkësi.

Marijana Toma: Në atë periudhë, unë do të isha ndalur pak këtu tani, mbase një pyetje të shkurtër, do të thotë, gjimnazi, si duket tani, do të thotë ju keni ardhur në të vërtetë në klasën e pestë, kjo më intereson si ishte ai lloj kalimi, a je ndesh ti me këto situata siç janë...?

Stefan Surlic: Jo, jo.

Marijana Toma: Atje? Atë që më kanë thënë miqtë e mi se fëmijët kanë përjetuar gjëra këtu [mendon kundër të shpërngulurve që janë në Serbi nga kjo periudhë]?

Stefan Surlic: Jo, në asnjë moment, bile e kundërta, ishin më të ndjeshëm ndaj meje në atë kuptimin se menjëherë afër meje ishte edhe drejtori edhe pedagogu. Unë kam pasur fat që ishte ky kalim, tani nuk e di se si është situata në shkollat e Serbisë, por më herët ka qenë se nga klasa e katërt krijohen klasat e reja kështu që të gjithë janë nga dy ose tre që njihen në mes veti por një numër i madh nxënësish në klasën tonë nuk janë njohur më parë. Eh, atëherë ishte e lehtë për t'u mos krijuar as edhe një kontakt.

E dyta, ka pasur mjaft fëmijë për shembull të punëtorëve sezonal, njerëz nga Serbia, themi, njerëz që jetojnë dhe njësoj flasin dialektin, dhe të cilët kanë qenë në klasa të ndryshme dhe unë e kisha plotësisht atë [dialekt], kam qenë shumë i mirëseardhur dhe plotësisht i pranuar. Madje më duket isha në klasën e pestë kur më zgjodhën kryetar klase, në fakt i paraleleve, mua më kanë zgjedhur, unë për veti nuk e njoh këtë lloj mos pranimi në shoqëri, nuk e kam përjetuar në Mal të Zi, në këtë jam shumë i sigurt kur e them se kam qenë i pranuar shumë mirë në Mal të Zi, se kam qenë mirë i trajtuar dhe bukur mirë i integruar.

Marijana Toma: Super. A e kishim bërë tani një pauzë? Kaluan 54 minuta.

Pjesa e Dytë

Marijana Toma: Mirë, po e vazhdojmë intervistën. Mirë, më thuani, ti fillove të flasësh se pse u përcaktove për shkencat politike. A mos ke pasë edhe ndonjë arsye më tepër dhe pse në Beograd, pse jo për shembull në Podgoricë?

Stefan Surlic: Po. Po unë kisha arsye, së pari më ka interesuar politika, në atë kuptimin e një hulumtimi të mirëfilltë të proceseve politike, e kam parë veten si politikolog. Kjo nuk i ka pëlqyer shumë prindërve të mi, megjithatë ata gjithmonë kanë qenë për atë që unë duhet vet të zgjedh degën që e dua dhe çfarëdo që zgjedh unë ata do të më përkrahin, prandaj edhe këtu nuk kishte ndonjë dilemë të madhe sa i përket anës sime. Nuk insistuan që të regjistroj diçka tjetër, por për babën tim si njeri që është nga bota e teknikës, ato shkencat politike, çka janë ato, a është fakultet, a është shkollë e lartë (qeshë)? Nëna ime prapë nga ana tjetër, “O bir regjistroje drejtësinë, unë jam juriste edhe gjyshi yt ka qenë jurist dhe kështu, po them edhe nëse ke dëshirë të merresh me politikë dhe procese politike, mundesh edhe me drejtësi.”

Megjithëse mua në fakultet më ka interesuar edhe gazetaria edhe publicistika, por përsëri vendosa për shkencat politike, duke llogaritur se edhe nëse merrem me gazetari, mundem edhe nga politika, por studimet më kanë shpër në një anë tjetër ku më interesonin disa tema tjera dhe për gazetari nuk kam menduar më fare, vetëm pas vitit të dytë të studimeve. Kam qenë student i mirë, i shkëlqyeshëm gjatë studimeve dhe më është dhënë mundësia të jem bashkëpunëtor në lëndën që shumë e kam dashur, e kjo është Politika krahasuese, sistemi i politikës moderne, të mësuarit e të gjitha proceseve politike, organizimi i qeverisë vertikale dhe horizontale, sistemi i partisë dhe drejtësisë, ishte një hapësirë mjaft e gjerë hulumtuese, thjeshtë u hapë mundësia, profesorët ma kanë dhënë këtë mundësi që unë vërtetë të bëhem bashkëpunëtor njëherë edhe asistent në fakultet e edhe ky është një tregim i imi.

Gjatë studimeve gjithashtu, shumë kam qenë i angazhuar, sipas seminareve të ndryshme, programeve, shumë kamë udhëtuar, e kamë shëtitur gjithë Evropën, kamë udhëtuar edhe nëpër regjion dhe kështu kam vazhduar. Me duhet të pranoj se më shumë dëshiroj të shkoj diku në regjion dhe në vende të vogla, se sa nëse dikush do të më ofronte... sepse ky regjion është shumë i pasur dhe ndryshe në çdo aspekt, kur shikon dhe e krahason vetëm në pikëpamje gjuhësore, linguistike, serbisht, rumanisht, shqip, greqisht, këto gjuhë në asnjë mënyrë nuk kanë ngjashmëri, nuk kanë pikëtakime në një vend aq të vogël të gadishullit Ballkanik. Dhe posa dikush të ofron ndonjë lloj udhëtimit, ndonjë lloj seminari në regjion, unë jam i pari që paraqitem. Dhe...

Dhe e gjitha është nga dëshira për të kuptuar, po e përsëris, për të kuptuar çka po ndodh, të kuptoj çka po ndodh me procese politike, dhe të ia shpjegoj vetës se tani kam mundësinë t'ia shpjegoj studentëve se si funksionojnë proceset politike, si funksionojnë institucionet, çka ndikon në to dhe e dua thirrjen time [si profesor] dhe vet lëndën sepse është inovative. Të gjitha zgjidhjet, të gjitha situatat politike, kriza sjell diçka të re për të mësuar në shkencat politike. Dhe nuk e kisha ndërruar këtë sferë me të cilën merrem as në ditët e sotme.

Marijana Toma: Më thuaj si të dukej ardhja jote, mirë po supozoj se ju keni qenë në Beograd edhe më herët, mirëpo ti faktikisht po shpërngulesh, baba i juaj është ende atje në Tivat apo edhe ai erdhi?

Stefan Surlic: Po, ai ka mbetë akoma atje, do të qëndroj atje deri në pension, atij i kanë mbetë edhe disa vjet dhe pastaj ai ka punuar në shkollë fillore, pastaj mendoj një kohë edhe në shkollën e mesme. Kështu që ka vendos ta përfundoj karrierën e vet të punës atje. E në këtë pyetjen pse vendosa që kjo të bëhet bash në Beograd, së pari se këtu e kam nënën dhe motrën ato kanë jetuar në Beograd, e dyta nuk e di por unë jam i formuar në Mal të Zi, asnjëherë nuk kam folur dialektin, do të thotë disi as nuk e komë përjetuar Podgoricën e as Malin e Zi si një vend që e shoh vetën në përkryerjen time të mëtutjeshme.

Beogradi ishte vendi ku e kam motrën dhe nënën ku e kam familjen e ngushtë dhe të gjerë dhe në njëfarë mënyre është vendi ku kam qenë gjithmonë gjatë pushimeve verore e dimërore, unë pushimet i kaloja në Beograd. Sidomos nga ana e nënës, meqë gjyshi është Beogradas i vjetër, poashtu e kam familjen e ngritur, prandaj përpiqem edhe sot e kësaj dite që t'i vizitoj të gjithë, të flasim...

Marijana Toma: Si të është dukur tani kjo, po supozoj se për ty ka qenë njëfarë lloj shoku, mendoj tash për ty është qyteti i tretë në të cilin jeton për kaç pak vjet, dhe ky është tani Beogradi, është FSHP⁷, njëri nga fakultetet më prestigjioze në këtë qytet dhe ti tani arrinë me këtë *background* [prapavijë], Kosovë, Tivat, Mali i Zi. Si të dukej kjo në fillim, miqëve të tu, njerëzve me të cilët ke rënë në kontakt në fakultet, por edhe për ty?

Stefan Surlic: Ndoshta për shkak të vjetëve të mia, ndoshta për shkak interesimeve të mija, disi, unë gjatë shkollës së mesme kam shkuar në Petnicë dhe në Tivat, pa marrë parasysh se çfarë ofron prapë se prapë është provincë, dhe në një moshë aty rreth 17, 18 vjeç, ju ndjeni se si ai mjedis, të paktën unë ashtu jam ndjerë, ta zenë frymën. Mezi kam pritur të jam në një qytet të madh dhe të shfrytëzoj atë që të ofron Beogradi, sidomos mendoj se ky lloj integrimi ndodhi shumë shpejt. Sepse fakulteti është për të gjithë, madje edhe për ata që kanë jetuar në Beograd, diçka plotësisht e re, një përvojë e re.

Takohesh me njerëz nga mbarë vendi, fillon diçka e re, të gjithë njësoj nuk e kanë ndonjë përvojë në këtë drejtim. Kështu një lloj ndryshimi por që ndikon shumë pozitivisht, edhe unë e ndjeva dhe e desha këtë lloj ndryshimi, kështu që nuk kam përjetuar ndonjë lloj shoku, vetëm jam gëzuar me rastin e regjistrimit në fakultetin të cilin unë e desha. Familja ime kishte pak frikë, në sensin që ti po vjen nga provinca, me atë gjimnaz, a do të mundesh ti të matesh me ata studentë, a do ta japësh provimin pranues. Babai im ka shkuar për ta shikuar listën (qesh) dhe tha, "la fillova nga fundi, pastaj shikova

⁷ Akronim për Fakultetin e Shkencave Politike

lartë.” Tha, “Kur e kam parë se ti je në mesin e atyre nga të parët unë jam shokuar. Unë i thashë, “Babë çka ke pritur ti, vërtetë!”

Jo, por kjo është bota e prindërve të mi, si do të jem unë në krahasim me ata fëmijë që kanë mësuar në Beograd, se nuk mund të maten ata fëmijë prej province me ata, mendoj se është kjo një mashtrim i madh dhe kjo është një porosi, sidomos ata që i kanë familjet dhe fëmijët në Beograd. Sepse Beogradi sado që të ofron më shumë përmbajtje, të ndalon në kohë dhe hapsirë që të mos i arrijsh të gjitha këto, por edhe njerëzit e ri, shpesh i ngreh në njëfarë mënyre që të kenë disa interesime që të shpërqendrojnë.

Po e përsëris, mjedisi i vogël si Tivati mua më ka mundësuar që unë të arrij që brenda ditës, që pas shkollës të shkoj në shkollën e muzikës dhe të shkoj në trajnime të futbollit dhe të marrë pjesë në seminare të ndryshme të organizatave jo qeveritare të cilat në atë kohë ishin shumë aktive, dhe të takohem me shoqërinë, të shëtisim, dhe gjatë fundjavës të dalim, sepse ai mjedisi i vogël të jipte mundësinë të organizohemi pasi që të gjitha ishin pesë minuta larg, dhe koha disi më ngadalë kalon.

Ju këtu, unë tani po e shoh përmes miqëve të mi të cilët kanë edhe fëmijë, vetëm sa të shkojnë në një vend, qoftë sport apo ndonjë aktivitet shtesë, atyre iu duhet ta ndajnë gjysmë dite pas shkolle. Kështu që, unë ndihem se i kam pasur përparësitë e mia në raport me shumicën kur erdha në Beograd, jo se unë isha diçka i veçantë por sepse unë kisha parakushte të mira para studimeve.

Dhe Fakulteti i Shkencave Politike është një vend i veçantë, njerëz të ri të cilët i kanë qëndrimet e veta, të cilët i ndërthurin argumentet e tyre, lidhur me studimet bazë, kjo ka qenë gjenerata e dytë e Bolonjës⁸, kështu që edhe profesorët janë adaptuar, dhe ka qenë një përvojë e mirë dhe e posaçme, prej vitit të parë kur jemi njoftuar me teoritë e politikës antike e deri te teoritë bashkëkohore, të jep një njohuri të përgjithshme, pranë politikologjisë studimet kanë qenë aq mirë të menduara sa që të japin një kulturë, edukatë, një gjerësi që edhe përmes lëndëve mund të observohen edhe çështjet ekonomike, të drejtësisë, çështje të natyrës juridike, nga të gjitha nga pak, pasi që është e nevojshme për ta përcjellë mbarë procesin politik.

Marijana Toma: Më thuaj tani, ti e përmende se për herë të parë je kthyer në Kosovë në një lloj vizite në vitin 2004. A është kështu?

Stefan Surlic: Ai po, unë tani nuk mund të kujtohem saktësisht, tani do ta kthej filmin, nuk besoj se ishte viti 2004. Sepse atëherë kanë qenë *martovski pogrom* [trazirat e marsit]⁹. Mendoj se ajo ishte

⁸ Me nënshkrimin e deklaratës së Bolonjës në vitin 1999 filloi procesi i Bolonjës, i cili ka për qëllim krijimin e një sistemi të veçantë të arsimit dhe hulumtimit universitar, njikohësisht njohjen dhe mirëmbajtjen e veçantive nacionale (kulturën, gjuhën, traditën etj.) me qëllim të krijimit të edukimit më fleksibil në Evropë, i cili do të ishte konkures edhe në trendin botëror të dijes. Deri më sot, deklaratën e Bolonjës e kanë nënshkruar mbi 40 vende të Evropës përfshi këtu edhe Kosovën dhe Serbinë.

⁹ Termi i cili përdoret në Serbi për t’iu referuar trazirave të marsit, i cili shpërtheu në mars, 2004, pas mbytjes së dy fëmijëve shqiptarë nga fshati Çabër, për këtë aksident shoqëria shqiptare akuzoi serbët nga fshati Zhupç, me ç’rast ka filluar sulmi mbi vendbanimet serbe në Kosovë, ku u vranë mbi 20 veta, shqiptarë dhe serbë, dhe një pjesë e madhe e kishave dhe manastireve serbe u shkatërruan, poashtu dhe prona private e serbëve që jetojnë në Kosovë.

atëherë në 2005 apo para vitit 2003. Mendoj me 2004 sigurisht nuk ka qenë. Por e di se ishte para studimeve, akoma isha në shkollën e mesme.

Marijana Toma: Si dukej ajo? Mendoj cili ishte motivi? (e pakupt.)

Stefan Surlic: (e pakupt.) Kjo ishte vërtet krejtësisht e rastit. Shkuam me disa miq tonë, me disa kumarë dhe gjyshja ime vendosi të kthehej dhe të jetojë në Kosovë. E ne, siç ua kam thënë e kishim shtëpinë në një fshat afër Lipjanit, aty ku ne shkonim për fundjavë, atë e ka ble babai im në vitet e '80-ta, dhe aty vendosi gjyshja për të jetuar. Ajo nuk ndihej rehat në Beograd, nuk kishte dëshirë të jetonte atje, nuk donte të bëhej barra e askujt edhe pse ajo nuk ishte barra e askujt, por ja që donte thjeshtë qetësinë e saj prandaj ne shkuam atje.

Dhe vërtete ishte shqetësuese, sepse kudo, ishim në Lipjan që gjyshja të shkoj dhe të... Deri te posta, deri te banka, po, dhe posa të flasësh serbisht, përnjëherë qetësi, të gjithë do ktheheshim, të gjithë shikohemi sepse ishte periudha e pas-konfliktit, me të vërtetë serbët të cilët kanë mbetur për të jetuar ishin në një geto absolute. Nuk kishin dalur fare nga fshati, nuk kanë dalur nga vendi dhe pas lufte të dëgjohet gjuha serbe në ndonjë mjedis urban në Kosovë, përveç në Mitrovicë, ishte një çudi, një çudi e vërtetë dhe ishte e nevojshme të dalin me përcjellje të KFOR-it, policisë, nën përcjellje që të ju sigurohej lëvizja. Në atë çast, në atë fshat afër kooperativës ishte improvizuar ambulanti dhe po e shoh veturën e ndihmës së shpejt e cila ishte me reshetka. Dhe tani një ndihmëse e mjekut, motër e cila erdhi për të dhënë injeksion një fqinji afër, tregonte, tha, "Ja tani sa shkrepën në neve." Këtë e tha me një lloj ngathtësie, sikur, "Ja, tani po sa hymë në fshat." Dhe vërtetë ajo veturë ishte me reshetka. Dhe tha, "Vazhdimisht, në çdo të tretën – të katërtën ditë, veprojnë ata kështu."

Mua më kujtohet që kam pasur shumë frikë në ato çaste kur i tha ajo ato fjalë dhe prandaj unë të them, "Ndaj, ne duhet të dalim nga ky fshat", mendoj. Athua, a do të jetë ndonjë i marrë tani këtu duke pritur që të kaloj ndonjë veturë në hyrje apo në dalje dhe të shkrep në neve. Për habi, baba im nuk ndiente asnjë lloj frike dhe prapë kemi shkuar për Mal të Zi, u kthyem edhe atë nëpër Pejë, Bjeshkëve të Nemura e tjera, e tjera. Edhe u ndalëm te pompa dhe me të thënë të drejtën nuk patëm ndonjë lloj situatë përveç, po mendoj vetëm një herë pata një shok kur disa njerëz shikonin kah ne dhe komentnim si ne po flisnim serbisht dhe jemi serb.

Por, unë e kujtoj kur erdha në Tivat, për shkak të sasisë së stresit dhe gjithë atyre, kështu që për disa ditë, disi nuk kam pasë dëshirë që të komunikoj, jam ndjerë shumë keq, madje bash mendoja mos do të më shpërfaqet diçka edhe në shëndetin tim, ndonjë temperaturë apo diçka. Sepse në atë kohë unë më nuk isha fëmijë, në vitet e '90-ta themi disa gjëra nuk po i kuptoja, por tani isha nxënës i shkollës së mesme dhe e kuptoja se ç'është duke ndodhur në Kosovë, shikoja se si jetojnë njerëzit në kushte jo njerëzore, në geto, nuk guxonin të dilnin për të blerë artikujt ushqimor, dhe e pashë kur dikush ia shkrep veturës, auto-ambulantës e cila kishte kaq {tregon me duar} një kryq prapa, veturë e bardhë, do të thotë. E shihni kjo ishte një ngjarje e një shkallë të urrejtjes në periudhën e pas luftës dhe kjo më...

Pastaj natyrisht kam shkuar më shpesh, pasi që situata po e merrte një formë të normalitetit të vet, që përsëri serbët kishin mundësi të lëvizin normalisht dhe ishte programi i Iniciativës së të Rinjve për të

Drejta të Njeriut, ai *mobility* programi dhe në të vërtetë, ky në të vërtetë ishte programi i parë në të cilin unë kam qenë si student dhe ku kemi qenë, bash në Prishtinë.

Marijana Toma: Ti ke marrë pjesë në atë program shkëmbimi?

Stefan Surlic: Po, në të vërtetë.

Marijana Toma: Cilin vit?

Stefan Surlic: Au, unë mendoj që kjo ishte diku kah vitet 2008, apo e 2009.

Marijana Toma: Si të është dukur ty, nga fakti se ti je nga Prishtina?

Stefan Surlic: Shumë emocionuese, sepse atëherë për herë të parë pata shkuar afër deri te ndërtesa jonë dhe deri në oborrin tonë, aty ku jam rritë. Më kujtohet se si përnjëherë çdo gjë m'u duk miniaturale, sepse unë e mbaja në mend një fotografi nga fëmijëria ime dhe tani një ndryshim i madh, do të thotë pas një kohe të gjatë, pas një periudhe të gjatë kohore nuk kisha qenë në ato vise dhe tani ja erdhi njeriu i rritur dhe si student, e i ke ato fotografi nga syri i një fëmije prej nëntë vjeç, apo dhjetë vjeç. Dhe pastaj përnjëherë ato ndërtesa m'u duken më të vogla, të vogla shumë, ato trotuare, rrugët, njerëzit dhe çdo gjë, por ishte shumë, shumë emocionuese dhe kjo më ka shkaktuar dhimbje.

Sepse unë them, ai qytet kishte një popullsi rreth 40,000 serb, tani jetojnë diku afër njëqind të cilët punojnë kryesisht në institucionet e Kosovës dhe ata kryesisht nuk kanë fort lidhje me Kosovën, do të thotë, unë mendoj se mbi 50-60 përqind janë nga Serbia dhe madje nuk kanë origjinë nga Kosova. Janë ndërruar për një kohë të shkurtër, së pari u ndërrua struktura e popullsisë, prej atyre 40,000 njerëzve, miqtë tonë, fqinjët, shokët e mi te shkollës më nuk jetojnë aty, e saktësisht më kujtohet ku kanë jetuar në cilën hyrje, në cilën shtëpi, në cilin oborr dhe gjithçka tjetër, kjo ishte një botë që më nuk ekziston.

Dhe e dyta, janë ndërruar emërtimet e rrugëve, asnjëra rrugë më nuk është siç ishte dikur. Këtu tani më nuk ka asnjë dëshmi që ne dikur kemi jetuar këtu. Kjo për mua ishte shumë mbresëlënëse e isha fëmijë. Unë për veten time kam arritur të kam një jetë të re, por mendohem se si ndihen prindërit e mi apo gjenerata e tyre, të cilët e kanë lënë jetën në Prishtinë, të cilët pas luftës kanë qenë të detyruar të fillojnë jetën nga zeroja, dhe sërish të ballafaqohen me faktin se dikur kanë jetuar në një qytet i cili atyre ua ka fshirë të gjitha gjurmët, po mendoj. Unë shpesh bëjë shaka dhe them, "Isha në qytetin i cili më nuk ekziston, në atë të njëjtin në të cilin më lindën, në të ka njerëz dhe tema, por nuk kam shtëpi kah e cila do të shkoj." Mendoj në vargje, mirëpo vërtetë, qyteti i cili ishte vendlindja ime, por tani më nuk është i imi sepse unë më nuk i njoh ato pamje të cilat i shoh tani, por vetëm një pjesë e kujtimeve të mija. Nuk ka asnjë fakt real që unë vërtetë dikur kam jetuar aty, dhe kam qëndruar aty me familjen time.

Marijana Toma: A ishte atëherë, hera e parë që kontaktuat me njerëz të ri, me moshatarët tu, me të rinjtë shqiptarë nga Kosova, në atë program?

Stefan Surlic: Po, po, kjo ishte hera e parë.

Marijana Toma: Si ju ka dukur juve?

Stefan Surlic: Unë nuk e kam pasur as edhe një grimë rezistence, as që solla asnjëgjë nga shtëpia ime. Do të thotë, pas ndodhjeve të luftës, prindërit e mi e kanë përsëritur, “Ka njerëz të mirë dhe të këqinj, e sheh që edhe neve njerëzit na kanë ndihmuar edhe pas luftës, na e kanë ruajtur banesën, i kanë ruajtur disa gjëra, pasurinë e cila për neve ka qenë e vlefshme dhe të gjitha të tjerat.” Do të thotë ata të gjitha i kanë bërë vetëm si miq edhe si fqinjë apo thjeshtë për arsytet njerëzore dhe humane.

Nuk kam pasur kurrfarë rezistence, përkundrazi kisha dëshirë të bisedoja me ata, ndërsa të rrallë janë ata të cilët kanë lindur në Prishtinë dhe janë rritur aty, sepse shumica e të rinjve sot, rinia ka ardhur nga Gjakova, Peja apo ndonjë fshat nga i cili e kanë origjinën prindërit e tyre, kështu që edhe ata njoftoheshin me Prishtinën tek më vonë, gjenerata ime. Por ka edhe asi të rrallë të cilët janë vërtetë të lindur në Prishtinë, ishte bukur që, si të them, po unë kam qenë me ata shumë më i afërt në raport me të tjerët në grup, sepse ne i kujtonim disa gjëra nga fëmijëria, do të thotë disa nga ëmbëltoret të cilat quheshin “Bosna”. Të gjithë fëmijët kanë pasur dëshirë të shkojnë në ato ëmbëltores dhe ato akulllore që i donim, disa gurabija, pastaj disa shitore të lojërave në të përparshmen, në qendrën tregtare “Boro e Ramizi”, pastaj edhe në rrethinë, parqet e qendrës ku kemi luajtur, Gërmia, vend me zë si për shembull në Beograd, Koshutnjaku, me lojëra e toboganë.

Duke i përfolur ato pamje të dikurshme të fëmijërisë, filluam në shpejtësi të afrohemi, shpejt por ishte një moment i cili për mua ishte shumë interesant, deri sa ne flisnim ashtu në gjuhën angleze, kaloi një njeri, megjithëse unë edhe me grupin tim e kam përdor serbishten, u afrua një njeri dhe me pyeti mua ashtu pak si i hidhëruar, “Prej nga je ti?” E unë sikur, i thashë, “Nga Beogradi, nga Serbia dhe për momentin jetoj aty.” Dhe tha, “Po, po, origjinën?” I thashë, “Po, i lindur jam këtu në Prishtinë,” e tjera. Dhe pastaj e pyeti këtë në gjuhën shqipe, “E ti, prej nga je?” Tha, “Po edhe unë nga Prishtina” dhe tani atij ia shpjegoi. Tha, “Shikoni, ju qenkeni të lindur këtu, dy njerëz të rinj, me origjinë nga kjo tokë, nga ky qytet dhe po flisni në gjuhë të huaja, në gjuhë të largët, në gjuhën angleze.”

Mendoj, unë për këtë nuk kam menduar, por në atë moment kur ai tha ashtu, thashë, po e kuptoj të tërën në esencë, këtu jetojmë me qindra vjet së bashku pranë njëri tjetrit serb e shqiptar dhe vërtetë ne po flasim me një gjuhë të huaj dhe të largët atë angleze. Dhe kjo është në të vërtetë, ishte një disfatë, si Ballkanas, të cilët në vend se të ndalemi të verifikojmë kush e ka të drejtën historike mbi këtë tokë dhe të kthehemi e të themi, pritni, të gjithë kemi të drejtë në këtë tokë në të cilën jemi, në të cilën jemi të lindur dhe nuk guxojmë kurrë t’ia mohojmë të drejtën tjetrit.

Marijana Toma: Pas asaj here a ke shkuar përsëri në Prishtinë, njësoj përmes seminareve apo a ke shkuar edhe vet?

Stefan Surlic: Po, kam shkuar, e kemi vazhduar atë program. Pastaj vetëm unë i dërgoj çdo vit nga dhjetë studentë në Prishtinë dhe në Graçanicë.

Marijana Toma: Nga fakulteti?

Stefan Surlic: Nga fakulteti. E më së shpeshti [shkojnë] ata njerëz që nuk kanë qenë asnjëherë, as që janë të lindur në Kosovë, për të analizuar gjithë këtë proces të marrëveshjes së Brukselit në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Unë më vonë jam marrë me Kosovën, i kam punuar disa punime lidhur me situatën e tanishme politike të serbeve. Shkruaj për këtë temë dhe më intereson dhe mendoj se edhe si politikolog kam më shumë mirëkuptim edhe për qëndrimet e serbeve dhe qëndrimet e shqiptarëve

shumë më mirë se dikush që vjen nga larg, dhe për këtë kam marrë disa komente prej atyre që jetojnë ‘poshtë’, sikur, “Mirëpo ti neve na kupton çfarë flasim ne, ne që lexojmë atë që e shkruan ti, aty është poenta.” Sepse dikush nga jashtë pa marrë parasysh sa është afër, nga Beogradi apo nga Tirana sikur do vinte atje, nuk e kupton kontekstin nëse vërtetë nuk ka jetuar atje dhe nuk e kupton mentalitetin e atyre njerëzve, çka është në të vërtetë ky lloj problemi politik, cila është prapavija e të tërës, e asaj që ndodhi dhe që po ndodh sot, ajo që ndodh sot në Kosovë.

Po përpiqem që ta shfrytëzoj këtë rast, meqë e njoh këtë vend, madje i njoh njerëzit, madje edhe në këtë kuptimin shkencor do ta jap kontributin tim dhe do t’u mundësojë edhe të rinjve të tjerë nga Serbia të cilët shpesh flasin për Kosovën, dëgjojnë për Kosovën, të shohin të vërtetën që po ndodh, të mundohen të kuptojnë. E ata që e kanë vuajtur, unë shumë më pak në krahasim me disa, mirëpo emëruesin e përbashkët që e kemi me ata që përjetuan diçka të keqe gjatë luftës e di që ata kanë më shumë mirëkuptim dhe ndjeshmëri se sa ata që kanë përfituar nga lufta.

Dhe shpesh bie ndesh me një lloj gjykimi, “Si mundesh ti, si dikush që i ka përjetuar të gjitha, i cili ka pësuar dëme në familjen e gjerë, si i dërgon tani studentët për t’i njoftuar me përfaqësuesit serb e shqiptarë?” Unë ju them, unë kam dëshirë që t’u jap atyre edhe vetës një përgjigje në disa pyetje. Dhe po përpiqem të kuptoj çfarë më ndodhi, athua mos m’i ka ngrenë ndonjë karkalec ato vite të fëmijërisë dhe të rritës sime? E ju që jetoni në mantrat tuaja dhe nuk përpiqeni që të kuptoni asnjë gjë dhe se asgjë nuk keni përjetuar gjatë viteve të ‘90-ta, nuk keni të drejtë të ulëroni në asnjë njeri që ka përjetuar diçka, në asnjë formë, sepse në esencë problemi i Kosovës është kjo mendësia e ‘kohës sonë’.

Ne jetojmë në një cikël të kohës në Kosovë, ku dhe kur serbët dhe shqiptarët kanë qenë në pushtet në periudha të ndryshme kohore historike, gjithmonë ka ekzistuar ‘koha jonë’. Mua baba më tregon, kështu, kur kemi qenë fëmijë, sidomos motra ime, deri në vitet e ‘90-ta, ka qenë shpërngulja e popullsisë serbe nga Kosova dhe atëherë unë e pyesja babën, “Cila është arsyeja, pse po ikin?” Së pari, në vendet rurale serbët vazhdimisht kanë pasur presion, shembuj të dhunimit, vrasjes së shtazëve, kallje [shtëpishë], dhe të gjitha të tjerat, “Ndërsa në qytet”, unë pyesja, “çka ka ndodhë?” Ai tregonte, “Shih biri im, që për shembull, unë me motrën tënde shkoja në ndonjë ëmbëltore, unë e thërrisja kamerierin në gjuhë serbe e ai dëgjon që thirra në gjuhën serbe dhe nuk dëshiron të më shërbejë. E kështu ti dhe unë ulemi, ti qanë, qëndrojmë më se gjysmë ore, ai aty sikur ka punë, në të vërtetë me qëllim nuk dëshiron të vijë.” E pse? Kjo është ‘koha e tyre’, ata tani janë në pushtet dhe serbët janë të padëshiruar.

Gjatë të ‘90-tave u përmbys kjo, pastaj serbët që e kanë përjetuar këtë me tërë energjinë jetësore, e edhe mu më kujtohet si fëmijë që pranë neve na ndaloi policia e përpara neve ishte vetura me shqiptarë dhe ata kinse i kontrolluan, dhe i dërguan në kooperativë për të ble cigare, për t’u ble ushqim e tjera. Më kujtohet se si komentonte baba i im, tha, “Vëni re fëmijë, për shkak të këtyre imtësive një ditë do të vuajmë shumë.”

Do të thotë, duhet të ndalet ky lloj cikli ‘koha e jonë’, duhet të vijë koha e të gjithëve dhe të jetojmë normal, eh përsëri për fat të keq, në Kosovë më duket se nuk janë nxjerrë mesazhet e duhura, sikur tani është koha e tyre koha e shqiptarëve dhe ja që serbet duhet të pajtohen dhe të mos kërkojnë asgjë, deri sa të vijë koha e tyre dhe kështu të shkojë në rreth, me nga njëqind vjet.

Marijana Toma: E më tregoni, kjo është mjaft interesante, tash këtë që treguat në një moment, kur të pyesin pse dikush si ti, i cili mes tjerash ka pësuar, e tani po i udhëheqë [studentët], tek cilat grupe ke hasur në këtë lloj komentimi, në Beograd, te kolegët e tu apo?

Stefan Surlic: Po, kryesisht në Beograd, edhe nga kolegët edhe nga miqtë, ndonjëherë si për mahi, ndonjëherë disa kritika serioze m'i kanë dhënë, gjoja se, "Cili është qëllimi yt i vërtetë?" Unë gjithmonë përgjigjesha se kjo është çështje tipike profesionale politikologjike, sikurse është dallimi në mes atyre, siç është ajo mahia, dallimi në mes të kriminelit dhe kriminologut, eh ashtu është edhe dallimi në mes të politik-bërësit dhe studiuesit të politikës.

Politikologu duhet plotësisht të jetë neutral, t'i përcjell proceset e caktuara politike dhe unë shpesh ju them studenteve, "Paramendojeni që nuk keni lidhje me Serbinë dhe serbët, identitetin shpirtëror të cilin e bartë Kosova mbi vete e të tjera. Sikur të kishit ardhur këtu nga një shtet i huaj, keni ardhur në Kosovë dhe ju duhet të shkruani raport mbi atë që ka ndodhur. Dëgjoni tregimin nga ana e serbeve, dëgjoni nga ana e shqiptarëve, çka ka ndodhur në të kaluarën, çfarë është tani problemi, dhe si duhet zgjidhur, vendosur. Ju jeni njerëz të politikës, kjo është detyra e juaj, ju kanë dërguar si hulumtues."

Dhe të gjithë kthehen të kënaqur, plotë ndjeshmëri dhe për një kohë të shkurtër prej tri-katër ditësh mësojnë shumë dhe thonë cili është dallimi në mes të asaj që ne kemi në media dhe çfarë kemi në realitet, jo që mediat përhapin të pavërteta, jo, por situata dhe mbarë konteksti është më kompleks, më shumë se sa na duket neve. E tëra e fiton një dimension njerëzorë, ndryshe nga ato që ne po i përmendim në disa llomotitje.

Marijana Toma: Na thuaj, kjo është shumë interesante, kemi folur pak edhe për këtë, duke pasur parasysh se jeni edhe në FSHP, dhe duke pasur parasysh profilin e studentëve themi cila është.... Se në kohët e fundit shumë shpesh po dëgjojmë se nëpër fakultete dominojnë njerëzit me qëndrime të theksuara djathtiste, athua, mënyra yte e punës a hasë në kundërshtim me mënyrën e tyre apo?

Stefan Surlic: Jo, unë kam fat që ligjëroj vetëm sistemet politike dhe merremi kryesisht me sistemin politik të Francës, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, SHBA-ve. Fusha ime e interesimit është sistemi i Ballkanit dhe kryesisht marrëdhëniet serbo-shqiptare dhe çështjet e Kosovës. Kështu që, unë po përpiqem që përmes të disa seminareve dhe edukimit shtesë të marrë pjesë edhe në këtë, sepse mendoj që ata duhet të dinë lidhur me demokracitë kyçe shumë më shumë sepse kjo është ndër provimet më të rënda në FSHP. Por sërish si njerëz të politikës do të ishte mirë të jenë ekspert edhe për Ballkan edhe për atë që është problem kyç i politikës në vendin tonë dhe më tutje, e ky është problemi i Kosovës, sado që mua do të më refuzojnë, pranojnë, në esencë problemi kyç politik i cili ndikon në këtë janë kufijtë, sa e kemi popullsinë, me çfarë kapacitete të infrastrukturës disponojmë, çfarë janë marrëdhëniet ndëretnike, në të gjitha këto duhet dhënë përgjigje e nuk po mund të japim përgjigje derisa e kemi çështjen e pa zgjidhur të Kosovës. Kjo është një çështje kyçe politike.

Kështu në këtë kontekst, sa i përket këtyre studentëve, unë ata i kuptoj sepse mirë më kujtohet se kur unë u regjistrova në fakultet, kam qenë të themi, jam shprehur më shumë si nacionalist, të themi ashtu, se sa sot. Sepse, mbase ka të bëjë me momentin, përmes edukimit, përmes analizimit të disa aspekteve, mua më është marrë mundësia që unë ta kem, unë të zotëroj të vërtetën absolute. Unë jam i vetëdijshëm që çkado që vërtetoj në bazë të të gjithave që i kam lexuar gjerë tani, i kam lexuar, i kam hulumtuar, asnjëherë nuk mund të jem i sigurt në çkado që vërtetoj, dhe kur i shoh njerëzit që i

shprehin qëndrimet e tyre pa ndonjë dilemë, plotësisht të sigurt, unë e di që ata janë zot të së vërtetës së tyre dhe me ta nuk ka diskutim dhe shkëmbim argumentesh. E këtu është pika.

Lu iku, dëshiroj që të flasë me njerëz të cilët i kanë argumentet e hapura, në këtë kuptim, që i kanë kristlizuar disa gjëra, që do të thotë se dëshiroj të takohem me njerëz të cilët nuk mendojnë si unë por që kanë hapësirë për dialog për të diskutuar, sepse në këtë mënyrë unë i vërtetoj shumë nga argumentet apo i hedhi poshtë ato, gjë që është dukuri shumë e shpeshtë, argumenti im, në mes të forcës së një argumenti më të fortë.

Po them, e kam pasur atë ngarkesë sepse identiteti im nacional nuk ka qenë aq shumë i theksuar në familjen time, ai i llojit “Ne jemi serb, Serbia, serbizimi” e të tjera. Kjo nënkuptohej si normale, nuk kemi pasur as këtë, as edhe këtë nacionalizmin e momentit apo diçka kundër, por thjeshtë kjo është faktike, kemi lindur, flasim serbisht, jemi Serb, e këtu, në këtë kuptim të identitetit nuk ka kurrfarë dimensionesh shtesë.

Mirëpo, në referendum, në fushata në Mal të Zi këto ndikuan në mua që të zgjohej tek unë identiteti nacional. Për arsye se njerëzit e politikës në Mal të Zi më shpesh e kanë shfrytëzuar termin serbët se sa Serbia, “Serbët na kanë okupuar më 1918, serbët janë fajtor, ata neve na pengojnë, serbët janë popull gjencidal, serbët janë kështu, serbët ashtu.” Sikur me na pasë thirrë me emër. I kam lexuar ato libra për hebrenj gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, mendoj se nuk është për një krahasim, por në atë moment të zgjimit të identitetit, sikur nuk jeni të vetëdijshëm se jeni hebre, por dikush thotë se jeni fajtor sepse ju jeni hebre.

Në këtë rast jam unë një person në moshë minore, ai dëgjon se serbët, do të thotë serbët tani më nuk përfaqësojnë ndonjë pushtet serb, apo për momentin pushteti aktual në Serbi apo edhe vet Serbia si ide, jo, do të thotë serbët si kolektiv dhe ju atëherë nuk mund t’i ikni sepse ju jeni të thirrur. Në çfarë mënyre ju do të përgjigjeni? E unë pastaj them, ndaloni, athua, a mundet dikush të më përjetoj në sensin politik si okupator i cili jeton në Mal të Zi? Unë për këtë e pyesja veten kur isha në shkollën e mesme.

Natyrisht, nuk ka pasur të tillë, të asnjë lloji, do të thotë të tilla situata që dikush mua sot do të më kishte bërë thirrje, jo për kundrazi, por unë përsëri jam ndjerë si pjesëtarë i asaj bashkësie e cila në një mënyrë shumë të bukur më ka pranuar dhe unë ia ktheva me atë që unë isha nxënës model, dhe kam marrë pjesë në shumicën e aktiviteteve të cilat i kanë afirmuar të rinjtë, e themelova klubin e të rinjëve në Tivat, i promovova gjithë çfarë kishte, organizova Ditët e Frankofonisë, do të thotë unë në njëfarë mënyre me pjesëmarrjen time modeste ia kam dhënë kontributin tim asaj bashkësie, e tani ajo e njëjta bashkësi në kuptimin politik më thirrte dhe më thoshte, “Eh, ju serbët, ju jeni armiq.”

Kështu që, unë kur u regjistrova në fakultet, unë e kisha një ngarkesë, o Zot po pse të gjithë janë kundër serbëve, çka është kjo, ne duhet që të organizohemi, por me të kaluar koha unë e kam kuptuar se shumica nga ata, natyrisht, se edhe ata të cilët pa arsye sulmojnë atë kolektivitet serbësh, por edhe ata të cilët fshehen pas identitetit me baza nacionaliste në të vërtetë janë dy fytyrat e të njëjtit kostum. Dhe ky lloj keqpërdorim te ne ka marrë hov të madh, e që unë po i frikësohem, do të thotë kjo po bie mbi gjeneratën që është e lindur ‘96, ‘97, ‘98, ata tani janë të pjekur madje edhe të ‘99, do të thotë ata së shpejti do të jenë, pra një gjeneratë që nuk e njeh luftën, nuk mbanë në mend viktimat, të

cilët as edhe periudhën e tranzicionit si periudhë e konsolidimit të demokracisë në Serbi nuk e mbajnë në mend.

Ne pa marrë parasysh të gjitha ankesave të kësaj natyre duhet të pranojmë se në dimensionin historik, ne jetojmë në radhët e atyre [shteteve] më të lira, të cilët megjithatë janë të ngopur në çdo aspekt, themi. Dhe ne jemi më të përafërt me botën moderne si kurrë më parë në histori, do të thotë shtetet tona dhe të tjerat në kuptimin teknologjik, ajo që paraqitet në Evropë dhe në Amerikë është për pak muaj, mbase edhe më herët gjendet edhe tek ne.

Në çdo pikëpamje, shikuar në literaturë, atë që e lexojnë studentët dhe shkencëtarët në univerzitete të Evropës, unë kam të njëjtën qasje në të dhënat hulumtuese sikurse edhe ata. Ajo që del atje, unë gjithashtu të njëjtën ditë i kam në llap topin tim. Në këtë kuptim, do të thotë, nuk flas për modernitetin kinse ne mbase jemi të zhvilluar, sa i përket infrastrukturës mund të barazohemi me ndonjërin nga shtetet e Evropës, megjithatë ne jemi afër asaj bote moderne dhe jetojmë në kushte të kohës së paqes, ku, e kjo është një hapësirë ideale për të zgjuar një lloj radikalizmi.

Siç është copëzimi i Jugosllavisë i cili ndodhi nga një çmenduri e plotë, do të thotë fundi i viteve '80-ta dhe fillimi i viteve '90-ta, sikur do i pyesnit ata njerëz se si keni jetuar, asnjëri nuk do të thotë se keq kanë jetuar, se paku në anën materiale. Mbase nuk janë ndjerë të realizur në kuptimin identitar si serb, si Kroat, si Boshnjak e të tjerë, por në esencë ky farë dimenzioni i mirëqenies ka ekzistuar. Eh, por pastaj dikush e mendoi dhe tha, "Eh, do të jetojmë edhe më mirë pa këta të tjerët" dhe kështu nga një situatë e papjekur erdhi deri te gjakderdhjet.

Unë vetëm po frikësohem se disa ide ekstreme nuk po na bëjnë nderë jo vetëm neve por mbarë Ballkanit, dhe pas një periudhe prej dy dekadash në paqe do t'i kujtohet dikujt dhe të thotë, "Hej, ne nuk e kemi përfunduar krejt punën." Nuk e kemi përfunduar punën dhe do të gjejë punë atyre gjeneratave të cilat nuk mbajnë mend. E kjo është një çështje që unë e përmendi dhe e përsëris shpesh edhe në Prishtinë, dhe them, "I zgjedhim sot çështjet e pazgjidhura, sepse kjo gjeneratë nuk ka vullnet më për konflikte sepse e dijnë çfarë sjell konflikti." Mirëpo për disa dhjetëra vjet, në Serbi do të rriten gjeneratat e reja të cilat do të thonë, "Dikush na e grabiti Kosovën më '99, neve na bombarduan, u flijuam për ta. Për kë? Për ata atje? Hajde të hakmerremi." Pse? Sepse nuk e mbajnë në mend luftën, nuk e mbajnë në mend sa kanë humbur, e problemi nuk është zgjidhur. Do të thotë, në interes të të gjitha palëve është të lëshojmë rrugë dhe të gjejmë një kompromis, sepse nëse mbesin çështjet e pazgjidhura, ato gjithmonë do të mbesin si element për konflikte të reja.

Marijana Toma: Ti sot je asistent në fakultet, e që është një sukses i madh (e pakupt.)

Stefan Surlic: Falemnderit.

Marijana Toma: Ky është sukses i madh, duke u bazuar në një numër shumë të madh të studenteve të cilët janë në FSHP, duke u bazuar në atë se kushtimisht ti nuk i përket grupeve elitare të Beogradit, gjegjësisht elitës politike serbe, a e sheh ti këtë si një sukses të madh, gjegjësisht cilat janë planet e tuaja të mëtutjeshme?

Stefan Surlic: Po, absolutisht e shoh si sukses siç e thatë edhe ju, kam ardhur nga provinca, e kam pasur rastin që të matem me kolegët tjerë nga gjenerata ime e të tjera, mua më është mundësuar kjo absolutisht në bazë të rezultateve të mija gjatë studimeve apo në bazë potencialit shkencorë e

hulumtues të cilin profesorët ma kanë njohur, por nuk është si një lloj llogaritje, por unë ndjej përgjegjësi, pasi që vërtetë mendoj se kjo thirrje kërkon shumë angazhim.

Poashtu ka pritje të mëdha, jo vetëm nga ana e studentëve, por duhet që gjithmonë të jesh i përgatitur, të përditësohemi me të gjitha informacionet e mundura, sidomos në një kohë kur çkado që themi mund të verifikohet shpejt dhe lehtë dhe mund të ofrojmë diçka të re, diçka që nuk mund ta gjejmë në google, por në mënyrë sistematike t'u përcjellim diçka që i bëjnë të mendojnë dhe i shtyen drejt një fryme kërkimore. Tjetra, pritjet nga bashkësia shkencore-hulumtuese, çka keni shkruar, çka po hulumtoni, ku keni qenë, në cilat konferenca e të tjera, cilat janë rezultatet e juaja shkencore-hulumtuese dhe cilat janë kontributet.

Dhe në fund, kjo është një thirrje ku ju gjithmonë duhet të dëshmoheni dhe të mbronni [qëndrimet], sepse ju jeni asistent, ju jeni docent, nesër ju jeni profesor i rregullt apo me korrespondencë, me çka e keni merituar këtë? Thjeshtë, thirrje e cila kërkon të jeshë gjithmonë në ballë të detyrës e cila nuk falë gabime, ato gjithmonë mbahen në mend edhe nga kolegët e punës edhe nga studentët edhe nga bashkësia e gjerë. Fakulteti i Shkencave Politike është megjithatë, siç ne e quajmë, shkolla e demokracisë, dhe një shoqëri matet përmes Fakultetit të Shkencave Politike.

Politikologët kanë për detyrë që ta kufizojnë pushtetin, kështu dëshirojnë të thonë disa nga profesorët tanë. Eh, sikur të ekzistonte ai element shoqëroro-politik aty ku po e kërkon publiku i gjerë nga ju t'i përgjigjeni thirrjeve të të gjitha atyre që po ndodhin sot në Serbi, në cilin drejtim do të duhej shkuar Serbia, dhe në çështjet e politikës së jashtme, politikës së brendshme, zgjidhjes së çështjeve politike. Kështu që, unë vërtetë shumë e dua thirrjen time, por është edhe këtu një dimension i përgjegjësive i cili do të më përcjell gjatë gjithë karrierës sime jetësore.

Marijana Toma: Si ishte, kjo ende më intereson, pastaj do të mbarojmë, kjo si është, kjo është eksperiencia e ime themi me kolegët e mi të rinjë, sidomos atëherë kur për herë të parë janë ndeshur me çështjen e ish-Jugosllavisë dhe luftën, dhe nuk dijmë tani, këto tregimet mbi krimet, si kanë reaguar njerëzit në ato? A keni përjetuar ndonjë rëndesë në lidhje me këtë kur keni shkuar ju, kur keni shkuar ju në Kosovë, pastaj bisedat mbi këtë temë, a kanë provokuar ndonjë konflikt apo ndryshim qëndrimesh?

Stefan Surlic: Me shqiptarë?

Marijana Toma: Edhe atje edhe këtu në Serbi.

Stefan Surlic: Po pra, natyrisht, unë çdo ditë bie në konflikt, natyrisht në kuadër të argumenteve dhe shpesh kam komentime nga ana e miqëve të mijë të cilët janë pro nacionalizmit dhe se unë në sytë e tyre jam liberal, ndërsa nga ata që janë liberal iu dukem nationalist. Kështu që, unë mendoj që kam gjetur qendrën ndërsa ju keni dal pak në ekstrem.

Por mua shumë më pengon që, pa marrë parasysh, sado që shikojmë objektivisht, në esencë edhe kur bisedojë me shqiptarë për situatën momentale në Kosovë, gjëja e parë, që kështu mund të them, çfarëdo koncesioni apo e drejte që i është dhënë serbëve në Kosovë nuk është realizuar pa presionin e bashkësisë ndërkombëtare. Dhe çfarëdo të ketë qenë koncesioni për bashkësinë serbe, ai është argumentuar nga elitat politike, jo kjo është mirë bashkësinë tonë shumë-etnike, por kjo është mirë pasi që do të largojë pengesat në rrugën drejt pavarësisë, do t'i qetësojë miqtë tonë ndërkombëtarë,

ne këtë duhet ta bëjmë, e dimë që është keq dhe e padrejtë që serbeve u japim çfarëdo të drejtash apo ligje të veçanta apo kjo që i përket tashëgimisë kulturore, por ne këtë duhet ta bëjmë thjeshtë sepse këto janë pritjet nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

Dimensioni i dytë është se serbët si bashkësi konstant përjetohen si armiq. Ata janë element kundër-shtetit, kundër-shqiptarëve dhe kurrësi të pranohen si bashkësi e cila ka të drejtë për të jetuar, e cila jeton në Kosovë. Dikush që është i lindur në Prishtinë, unë jam interesuar për çështjen e kishës së, “Hrista Spases” e cila është ndërtuar, edhe këtu kam disa argumente dhe shpesh diskutojmë me shqiptarët të cilët dëshirojnë rrënimin e kishës, duke argumentuar se është e ndërtuar në tokën e univerzitetit dhe se është ndërtuar sipas ligjeve të kohës së Millosheviqit, dhe kjo kishë është e Millosheviqit, simbol i se keqës e të tjera, dhe si e tillë duhet të rrënohet.

Në atë rast unë i kundërshtoj me argumente, së pari, si u krijua Univerziteti i Prishtinës, do të thotë Beogradit ishte ai i cili ka iniciuar zhvillimin e bashkësisë akademike në përgjithësi në një vend të pazhvilluar dhe rural, në Kosovë. Se dyti, klasat e para dhe departamentet ishin të Univerzitetit të Beogradit dhe ajo ushtria e atëhershme e Jugosllavisë atë sipërfaqe ku në të vërtetë kanë qenë kasarnat e tyre ua kanë ndarë Univerzitetit të Beogradit, pastaj kur u forcua ai departament, ka qenë e mundur të formohet Univerziteti i Prishtinës.

Tjetra, ky vend nuk ka qenë i menduar si ndonjë lloj kampusi, mirëpo thjeshtë për shkak të vetë shtrirjes kanë filluar të ndërtohen disa objekte. Dhe kështu, nëse kampusi është i kufizuar me rrugë, pastaj aty ndodhet ndërtesa e Radio Televizionit të Kosovës dhe disa dyqane tjera, që do të thotë nuk është fjala për ndonjë kampus të izoluar vetëm për fakultete dhe administratë të univerzitetit.

Tjetra, se kjo nuk pengon asnjë gjë, të gjitha çka janë ndërtuar në kohën e Millosheviqit, do të thotë ndërtesa të mëdha janë objekte të infrastrukturës, por ama bash kisha po pengon. Pse? Sepse ajo ka momentin etnik dhe religjioz. Tjetra, para kishës është një sipërfaqe e madhe, me qindra kuadrat ku mund të ndërtohen objekte të reja, dhe askush nuk ju pengon që të vazhdojnë natyrisht, sa më shumë që të zgjerohet univerziteti aq më mirë ndikon në rritjen numrit të njerëzve të arsimuar dhe arsimit të lartë. Dhe sidomos kur thonë, “Kjo është kisha e Miloshit” ai ishte njeri komunist dhe as që u varros me rregullat e kishës e tjera e tjera.

Mendoj, një ndërrim i tezës dhe një përrallë e pastër politike e cila është e pa bazë e sidomos kur kundërshtojnë me qëndrimin, “Prit, nëse ka katolik shumë më pak se ortodoks në Kosovë, e gjithë këto katedrale i keni ndërtuar, atëherë mendoj se, për shkak të harmonisë shumë-etnike do të ishte mirë që në Prishtinë të kishte xhami, edhe kishë të ortodoksëve dhe të katolikëve dhe kjo nuk do të duhej ta shqetësoj asnjë njeri dhe të ketë diçka negative ndaj kësaj kisha.”

Unë si prishtinas ndjej diçka edhe për atë kishë, e shoh si një simbol tragjik të të gjithë njerëzve që kanë jetuar në Prishtinë. Sepse afër 40,000 njerëz nuk jetojnë më atje, të shpërngulur, të dëbuar, shumica janë kidnapuar dhe vranë, nuk janë të gjithë kriminel, nuk mund të jenë kriminel, themi ekziston një masë, të themi se janë njëqind, por nuk janë të gjithë, 40,000 njerëz janë civil. Pastaj bash kjo kishë dhe moskryerja e saj edhe kjo dëshirë të rrënohet, unë personalisht si një njeri i lindur në Prishtinë e kam përjetuar si simbol i serbëve që dikur kanë jetuar në Prishtinë.

Marijana Toma: Mirë, unë kam një pyetje për fund, nëse ti nuk ke diçka për të shtuar eventualisht. Nëse dikush të ofron të shkosh të ligjërosh në Univerzitetin e Prishtinës, si profesor, a do të kishe shkuar?

Stefan Surlic: Po, do të shkoja. Dhe mendoj se ajo është detyrë e imja, për të shkuar. Si një njeri që ka lindur në Prishtinë, më paraqet një lloj barriere gjuha shqipe natyrisht sepse unë flas shqip sa për një komunikim elementar, mirëpo sa për të mos ligjëruar në gjuhën angleze nëse do më bëhej ftesa nga Univerziteti i Prishtinës apo në gjuhën serbe apo në gjuhën shqipe si dy gjuhë zyrtare tani në Kosovë. Por me dëshirë të madhe do të kisha shkuar, sepse mendoj që e vetmja mënyrë për serbët në Kosovë të mbijetojnë është nëse kthehen në qytete.

Jeta vetëm në vende rurale ka shumë mangësi, para se gjithash në kuptimin kulturor, themi bibliotekat, univerziteti, teatri, pa marrë parasysh sa mundohemi të bëjmë zhvillim në vendet e vogla, ata mund të ekzistojnë vetëm në qendra të mëdha urbane, dhe detyrë e politikës shtetërore duhet të jetë kthimi i serbëve në Prishtinë, Prizren, dhe atë nëse ekziston ndonjë strategji serioze. Ka shumë njerëz të ri sikurse unë dhe mirë të arsimuar dhe të suksesshëm dhe shpesh ne mblidhemi dhe diskutojmë sikur neve dikush të na bënte ftesë dhe të na thotë, “A do ktheheshit sikur të kishit kushte normale jetese, dhe poqëse kishit pasur një rol shtetëror, që ju si serb dhe si njerëz të arsimuar ktheheni dhe punoni në Prishtinë?” Me shumë kënaqësi.

Marijana Toma: Super. Shumë faleminderit. A ke edhe diçka për të shtuar?

Stefan Surlic: Asnjë gjë, kjo është kjo. Faleminderit juve për ftesën. Shpresoj se ka për të kontribuar paksa në kuptimin e të gjitha atyre që kanë ndodhur.

Marijana Toma: Faleminderit shumë, Stefan! Tani është 48, përkatësisht një orë e 48 minuta.